ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

çdo të shtunë

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 9 MAJ 2020. NUMËR 78. VITI II I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

In memoriam: MAKS VELO

PORTRET ARTISTI NE RINI. VERSION SHQIPTAR

nga Ismail Kadare

Dihet se pas rënies së komunizmit, nga vendet e ish- perandorisë u prit me kureshtje dhe padurim një letërsi e re, që do të dëshmonte në mënyrë të veçantë, më dramatike, më thellë dhe rrjedhimisht më bukur tragjedinë e këtyre popujve. U prit një gjë e tillë sidomos nga vende klasike staliniste si Shqipëria, burgjet e së cilës u hapën më 1991...



MAKS VELO DHE ARTET

nga Moikom Zeqo

Vdekja e Maks Velos me pikëlloi. Kujtova me ngulm të hovshëm dhe nostalgjik çastet, takimet dhe bisedat me të. Por është e vështirë të shkruash me një stil epigramatik diçka përfundimtare për këtë artist të shqetësuar si rrallëkush...

Kornizë dashurie për autoportretin e Ervin Hatibit

nga Virion Graçi

(fq. 6)

Kam qenë student në vitin e parë te *Filologjiku* kur u botua libri i parë i Ervin Hatibit, *Përditë shoh qiellin,* poezi, Botimet Naim Frashëri, 1989. Ai vetë ishte nxënës në shkollën e mesme, 14-15 vjeç, më duket. Libri menjëherë bëri emër, dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe.

REVISTA LETRARE DHE MISIONI I SAJ PREJ "PLACENTE"

Eseja si pjesë rëndësishme e revistës letrare

nga Mira Meksi

(fq. 12)

NJË PËRKTHIM MJAFT I TJETËRSUAR I BALADËS "DER ERLKÖNIG" TË J.W. GOETHE-s

(fq. 11)

nga Arb Elo

"Lumturia martesore" e Tolstoit, një vepër e përsosur rasiniane

Nga Romain Rolland

(fq. 8)

Një ditë do të kujtojmë gjithçka dhe do të shkruajmë një roman

nga Sloane Crosley

ÇFARË DO TË NDODHË ME ROMANIN PAS KËSAJ?

Mbi gjininë e pashmangshme letrare pas-pandemike

nga Emily Temple

TREGIME

Shazim Mehmeti: *Monologje* (fq. 8)

Biser Mehmeti: *Njeriu i marrë* (fq. 11)

POEZI

Paul Celan: *Fije të natës* (fq. 8)

Fehmi Ajvazi: *Imperum* (fq. 11)

PORTRET ARTISTI NË RINI, VERSION SHQIPTAR

nga Ismail Kadare



Skicë nga Gëzim Qëndro

Dihet se pas rënies së komunizmit, nga vendet e ish- perandorisë u prit me kureshtje dhe padurim një letërsi e re, që do të dëshmonte në mënyrë të veçantë, më dramatike, më thellë dhe rrjedhimisht më bukur tragjedinë e këtyre popujve. U prit një gjë e tillë sidomos nga vende klasike staliniste si Shqipëria, burgjet e së cilës u hapën më 1991. Njëfarë habitjeje për të mos thënë zhgënjim e pasoi këtë pritje. Në të vërtetë, nuk ka patur vend as për habi e as për zhgënjim. Letërsia ka ligjet dhe oraret e saj, kështu që stinët politike, madje, dhe përmbysjet e mëdha, qëllon që e trazojnë atë me shumë vështirësi.

Lidhur me letërsinë që u krijua nga shkrimtarët e burgosur (ajo që u shkrua, u konceptua, u shkrua tërësisht ose pjesërisht atje), ka patur për mendimin tim dy arsye kryesore, që nuk na ofroi befasinë që prisnim. E para, sepse ajo që ndodhte brenda burgjeve, në thelbin e saj nuk ishte tepër larg nga ajo ça ndodhte në jetën e përditshme. Ankthet, frika, tmerri politik ishin të të njëjtës natyrë, madje, mund të thuhet se qëllonte që në stinë të veçanta terrori, ankthet ndiheshin më shumë jashtë se brenda. Kështu që, kur të burgosurit dolën me dëshirën e natyrshme për të dëshmuar vuajtjet e tyre, ata gjetën jashtë shumë surpriza të hidhura. Arsyeja e dytë lidhet me atë që u përmend më lart, oraret e veçanta të letërsisë. Letërsia shqipe, pavarësisht se në pjesën dërrmuese të saj ishte e rrënuar nga "realizmi socialist", i mjaftonte trungu i paprekur i saj, i përbërë nga disa shkrimtarë, për të kryer, midis natës së diktaturës komuniste, një dëshmi antidiktatoriale. Kështu që, në njëfarë mënyre, pjesa më e mirë e kësaj letërsie ishte ndërkaq e një familjeje me letërsinë që do të krijohej në liri.

Maks Velo është një nga autorët që, si rrallëkush e kuptoi se krijimi letrar e artistik, në rastin e tij letërsia e piktura, pavarësisht se në ç'kushte lindën, janë në radhë të parë, art. Si e tillë, dëshmia e tij është e një vlere të dyfishtë.

Maks Velo, piktor dhe shkrimtar, ka qenë një i burgosur politik i mirëfilltë. Diktaturat komuniste kanë qenë mjeshtre të vërteta për të ngatërruar, kur ua lypte nevoja, shkaqet e dënimit të njerëzve. Shpesh qëllonte që kundërshtarë politikë të regjimit binin në burg të fajësuar si njerëz me vese, imoralë, kumarxhinj ose vjedhës, ose e kundërta, të tillët, shpalleshin si të burgosur politikë. Në të dyja rastet qëllimi ishte i qartë: çnderimi. Makina vepronte në dy kahe: zhvlerësimi i kundërshtarëve politikë, në rastin e parë, zhvlerësimi i vetë idesë së rebelimit politik në rastin e dytë.

Maks Velo ishte ndër të rrallët që u dënua drejtpërdrejt për artin dhe për mendimet e tij. Dënimi i tij ishte, gjithashtu, i veçantë për arsye se ai u dënua bashkërisht prej shtetit diktatorial dhe prej Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, pra prej kolegëve xhelozë të tij.

Ende njihet tepër pak aleanca e shëmtuar midis diktaturave dhe Lidhjeve të shkrimtarëve dhe artistëve në të gjithë perandorinë komuniste. Thelbi i marrëveshjes së pashprehur me fjalë ishte ky: Lidhja e Shkrimtarëve i shërbente me zell shtetit, i nënshtrohej çdo kërkese të tij, për dënimin e anëtarëve të vet, por edhe shteti herë pas here i bënte qejfin Lidhjes duke dënuar ndonjë krijues, dënim që e kërkonte ajo, për arsye xhelozie profesionale!

Maks Velo ishte një krijues, piktor dhe poet, që pati fatin e keq të jetonte nën një diktaturë. Ai u dënua si krijues nga shteti dhe kolegët e vet, puthadorë të shtetit. Në burg ai mbeti ai që ishte më parë: i burgosur politik dhe piktor e shkrimtar. Pas daljes nga burgu ai vazhdoi të ishte ai që kishte qenë: as kërkoi ndonjë revansh të bujshëm, as e ktheu burgimin në mjet përfitimi.

Libri i tij është vërtetimi më i saktë i kësaj vazhdimësie njerëzore. Për ne që kemi jetuar në ato kohëra të vështira, ka qenë gjithmonë kënaqësi kur takonim njerëz, që stuhitë e kohës nuk i përçudnonin dot. Kënaqësia është e dhjetëfishtë kur njerëz të tillë janë miqtë e tu. Maks Velo ka qenë gjatë më shumë se 30 vjetëve miku im. Gjatë kohës që ndodhej në burg, natyrisht edhe ai, edhe unë, kemi ëndërruar takimin e ardhshëm. Që do të më jepej rasti të prezantoja tregimet e tij për publikun francez, kjo e kapërcente çdo ëndërrim.

Porsa isha kthyer nga studimet nga Moska, kur u njoha me Maksin. Njohja me të ishte një zbulim për mua. Ishte fillimi i viteve '60, koha e paktë kur Shqipëria e porsa shkëputur nga kampi komunist po jetonte një periudhë disi liberale. I mërzitur prej thatësirës së letërsisë sovjetike e sidomos prej shkrimtarëve sovjetikë, një pjesë e të cilëve u ngjante, edhe nga pamja, edhe nga veshja zyrtarëve të Komitetit Qendror, në mënyrë të vetvetishme po më tërhiqnin shkrimtarët shqiptarë të mbetur nga koha e përmbysur e mbretërisë, ata që popullsia naive i quante "borgjezë". Në Rusi, pas dyzet e ca vjetëve të diktaturës, shumica e shkrimtarëve "borgjezë" ishin zhdukur, kurse në

Shqipëri diktatura ishte ende e re, pesëmbëdhjetë vjeçe, kështu që të vjetrit mund t'i takoje ende me shumicë. Tani, pas kthimit nga Rusia, ata po më dukeshin edhe më të çmuar. Kështu u njoha me Lasgush Poradecin, Dhimitër Paskon, Vedat Kokonën, Veis Sejkon e të tjerë.

Ishin të ndryshëm nga të tjerët. Të huaj krejtësisht për botën komuniste. Kishin kryer të gjithë studimet në Perëndim, mbanin borsalina nga të viteve '30 e '40. U puthnin dorën grave, e thërrisnin njëri-tjetrin me "zotni" e "zonjë". Më dukeshin të mahnitshëm në gjithçka: nga mënyra si të prisnin në shtëpi e, natyrisht nga ato që tregonin.

Dija jo pak gjëra për vetminë e Pasternakut, fushatën kundër të cilit e kisha përjetuar dy vjet më parë në Moskë, por vetmia e Lasgush Poradecit, shkëputja e tij nga koha, ishte kolosale. Poetin më të madh të gjallë të Shqipërisë, një pjesë e shqiptarëve e dinin të vdekur. Ai kishte të njëjtin mendim për epokën, e quante të vdekur.

Dhimitër Pasko, me natyrë të qetë, të kundërt prej Lasgushit nervoz, më dukej i mistershëm me fatin e tij: kishte qenë në stepat ruse, por jo si ne të tjerët, në kohën e miqësisë komuniste, por i mobilizuar me forcë në trupat gjermane, që po i afroheshin Stalingradit, pra, në anën tjetër të pasqyrës.

Një tjetër, Vedat Kokona, në shtëpinë e tij të vogël verore, të marrë me qira në ranishtën e Durrësit, më tregonte për plazhin në kohën e mbretërisë, për historitë e kronikën mondane, personazh qendror i të cilës kishte qenë edhe vetë.

Të gjithë këta njerëz më tërhiqnin por edhe më brengosnin, si diçka e pakthyeshme. Ishte një botë që po perëndonte me shpejtësi.

Befas, në këtë kohë, në Klubin e Shkrimtarëve, në një ekspozitë të sapopëruruar u njoha me një djalë të ri, pothuajse moshatar me mua, i cili ndryshe nga ne, shkrimtarët e artistët e rinj, të ardhur nga metropolet komuniste: Moska, Varshava, Budapesti, kishte misterin e atyre që po iknin, "borgjezëve". Ky ishte Maksi.

Nuk kishte asgjë prej romantikut të vonuar. As ishte nostalgjik i regjimeve të përmbysura. Përkundrazi, ishte një djalë i hijshëm e modern. Ngjyrimi "i dikurshëm" i vinte nga brenda. Ndihej menjëherë që, ndonëse i ri, ishte jashtë kohës. Ndryshe nga shumica e brezit të ri, që kishin si gjuhë kryesore ato të perandorisë: rusishte, hungarishten etj., Maksi lexonte frëngjisht e italisht. E kështu me radhë, në stilin e të folurit, të sjelljeve. Nuk dinte, ngaqë natyrisht nuk donte, të përdorte qoftë edhe në mbledhje terminologjinë e kohës, madje, as fjalën "shok" nuk e thoshte dot.

Ishte i heshtur e pa bujë në qëndresën e tij. Aq i heshtur, saqë gjatë hetimit dhe më pas, në gjyqin e tij, nuk u sollën dot si akuza fjalë a mendime të tij kundër regjimit. U dënua kryesisht për pikturat e tij, që u quajtën moderniste e dekadente. Një nga faktet që tërthorazi dëshmonte ftohtësinë ndaj regjimit ishte "qëndrimi i tij i pikëlluar në kafene". Ka mundësi që në krejt botën groteske komuniste Maksi të ishte i vetmi që të ngarkohej me një faj të tillë.

Maksi ishte inxhinier arkitekt. Gjatë kohës që i mbetej, pikturonte dhe lexonte. Bisedat tona në shtëpinë e tij (banonte disa minuta me këmbë larg meje), ishin një kënaqësi e vërtetë për mua. Atmosfera gjithashtu ishte e veçantë: atelieja i tij në katin e dytë të shtëpisë, motra dhe nëna e tij e mrekullueshme, që na sillte herë pas here ndonjë kafe dhe natyrisht ato që flisnin. E njihte mirë letërsinë dhe dramën e saj. Temë e parapëlqyer për të dy ishin natyrisht shkrimtarët e piktorët e huaj të ndaluar në Shqipëri: poetët "e mallkuar" francezë, Prusti, Kafka, Shagalli, Piccasso. Kur pas "Përbindëshit", që u ndalua si vepër moderniste, shkrova dhe botova "Kasnecët e shiut" (Kështjella), ai shfaqi drojën se mos nën trysninë e kohës po bëhesha si tepër realist. Për t'i treguar se unë vetë e kisha atë droje, i dhashë të lexonte dorëshkrimin e romanit "Kronikë në gur", për të cilin, siç do të thoshte më pas një kritik francez "realizmi ishte korrigjuar me pakëz marrëzi". Më kujtohet se titullin e gjetëm bashkë. Nganjëherë më merrte në telefon për të më thënë se në një përkthim të vjetër të "Biblës" në shqip kishte gjetur dy-tri fjalë të hershme, që mund të më hynin në punë.

Gjithmonë habitesha se si ia dilte që të merrej vesh me zyrtarët në Bashkinë e Tiranës, ku punonte prej vitesh. Përveç heshtjes e mbronte, ndoshta, mosshtirja e tij. Të gjithë e dinin se ishte tjetërlloj, ndaj dhe në një farë mënyre e pranonin. S'prisnin prej tij as zjarrmi entuziaste, as zell për të dënuar armiqtë, dy nga gjërat më të zakonshme në mbledhjet e asaj kohe.

Ndërkaq, Maksi punonte. Bënte projekte ndërtesash një pjesë e të cilave kryheshin, botonte tek-tuk ndonjë vizatim të parrezikshëm, shkonte në Klubin e Shkrimtarëve dhe Artistëve, ku natyrisht vazhdonte "të rrinte i pikëlluar".

Në atë kohë, shkrimtarët e artistët më të njohur, sidomos ata që nuk kishin zyra dhe punonin në shtëpi, kishin të drejtë për një dhomë pune. Apartamenti im në rrugën "Luigj Gurakuqi" ishte fare i vogël, i përbërë vetëm prej dy dhomash. Në vitin 1970, pas botimit të "Gjeneralit" në Francë, kur gazetarët e huaj trokitën disa herë pa paralajmërim në derën time, ngushtësia e apartamentit tim u bë problem, çka bëri që Bashkia e Tiranës të më vinte në listën e ngutshme për zgjerim.

Maksi erdhi një mbrëmje gjithë gëzim për të më njoftuar se kishte marrë vesh në Bashki, se pikërisht në ndërtesën që ai po projektonte, ishte parashikuar që unë të merrja një apartament.

Ndërtesa e projektuar ishte dyqind hapa larg, dhe pas fillimit të ndërtimit, pasi u siguruam se unë isha vërtet në listë, shkonim shpesh të dy për ta parë. Maksi ishte i guximshëm dhe pa pyetur askënd, te njëri nga apartamentet, ai që parashikohej "me një dhomë pune", bëri ndryshimet e nevojshme, në mënyrë që dhoma e punës të kishte një hapësirë të pazakontë për stilin socialist të banesave. Pa u mjaftuar me këtë parashikoi vendin e një oxhaku (domethënë zgavrinën thithëse të tymit), në mënyrë që "zjarri i përjetshëm" të më ndihmonte në punë! Ishte ndoshta i vetmi apartament në një ndërtesë banimi të përbashkët në Shqipëri, i projektuar me një oxhak. (Të dyja këto modifikime, hapësira dhe oxhaku do të bëheshin problem më pas, çështja do të shkonte gjer te kryeministri i shtetit. Vetë ndërtesa do të vihej në shënjestër të akuzave, sidomos pas dënimit të Maksit, do të quhej moderniste, kubiste, madje disa herë do të propozohej shembja e saj.)

Ndërkaq ne, duke mos parashikuar asgjë ëndërronim si do të bisedonim duke pirë kafe, ndanë oxhakut. Kishim caktuar dhe vendin ku do të vendosnim tablonë e tij më të dashur "Kënga epike", të cilën ai ma kishte dhuruar ndërkaq.

Ndërkaq atmosfera sa vinte po zymtohej në Shqipëri. Shpresat që hapeshin aty-këtu mbylleshin prapë. Flitej për një ftohje me Kinën, por asnjë shenjë afrimi me Evropën nuk dukej në horizonte. Njëlloj si në historinë e shkëputjes me sovjetikët në vitet 1960.

"Ora e kafesë tek oxhaku" sa vinte dukej më e largët. Ndërtesa "e jonë", herë për pengesa burokratike, herë për arsye smire të kolegëve të Maksit, ngrihej fare ngadalë. Disa herë punimet u ndërprenë, hapeshin fjalë se ishte skajuar keq, se do të anulohej.

Në jetën e Maksit ndodhi befas një ngjarje e habitshme. Një ditë trokiti te unë së bashku me një vajzë franceze. Mbeta gojëhapur ngaqë e dija se Maksi nuk bënte pjesë në ata njerëz, që shteti mund t'u besonte shoqërimin e një të huaje. Më tha se e kishte njohur rastësisht në Bibliotekën Kombëtare dhe kishte disa ditë që e takonte rregullisht. E askush s'të ka thënë asgjë për këtë? e pyeta. Askush, u përgjigj Maksi.

Kjo ishte gati e pabesueshme. Në Shqipëri, pas një bisede disa minutëshe me një të huaj, të thërrisnin të jepje shpjegime, e jo pastaj të shoqëroheshe ditë të tëra.

Dukeshin të gëzuar të dy dhe kjo më bëri që të mos ia thosha dyshimin tim se mos kjo heshtje e shtetit mbante erë kurth. Kur pas disa ditësh më tha se vazhdonte të shoqërohej me francezen dhe askush nuk po i tërhiqte vërejtjen, mendova se shteti kishte përfituar nga natyra e veçantë e Maksit për ta shtirë vërtet në kurth. Pas ikjes së vajzës franceze do ta thërrisnin me siguri për t'i bërë trysnitë e zakonshme.

Ata që e morën vesh, menduan se ishte kjo marrëzia që e rrëzoi përfundimisht fatin e Maksit. Unë kam menduar gjithmonë se ajo bëmë e tij, sado e jashtudhshme të dukej, nuk e ka dëmtuar drejtpërdrejt. Zyrtarët shqiptarë janë shqyer gazit. E kanë quajtur me siguri tuhaf, Don Kishot, të fantaksur. Megjithatë, sinqeriteti i tij, sado që sinqeriteti ishte i huaj e i paçmuar në atë botë, mund ta ketë ndihmuar. Lidhja intime me një të huaj shkaktonte dënim të rrufeshëm

në Shqipëri. Maksi u dënua shumë vite më pas. Veç një gjë ishte e vërtetë: kolegët e tij smirëzinj u gjallëruan kundër tij, pikërisht pas historisë me francezen. Në të vërtetë, ishin ata që do ta rrëzonin.

Më 1973, pas një periudhe të shkurtër liberalizimi, u ndie një acarim i ri në jetën e krejt vendit, sidomos në kulturë. Ishte një nga ato stinët e pritura me padurim nga shkrimtarët dhe artistët militantë, për të larë llogaritë me kolegët e tyre. Maks Velo bënte pjesë ndër ata që u vunë në shënjestër.

Për një kohë të gjatë nuk e gjeja dot se cili mund të ishte shkaku i vërtetë i atij mllefi të palodhur kundër tij. Me natyrën e tij të heshtur, me mënjanimin e sidomos me shpërfilljen e plotë ndaj karrierës, Maksi nuk rrezikonte askënd prej kolegëve të tij piktorë. Mirëpo ishin, me sa dukej, pikërisht heshtja dhe natyra e tij munguese që ia afruan fatkeqësinë. Të mësuar që të përndizeshin në mbledhjet solemne, që t'u dridhej zëri nga emocioni e t'u skuqeshin fytyrat nga ngazëllimi kur takonin udhëheqësit e partisë, turma e shkrimtarëve dhe e artistëve konformistë nuk e duronin dot dinjitetin e atyre kolegëve të paktë të tyre që rrinin mënjanë e si në hije në këto ngjarje. Mënjanimi i këtyre të fundit, fytyrat serioze e pa gëzim, ishin për konformistët entuziastë një sfidë e padurueshme. Maksi bënte pjesë ndër sfidantët.

Shenja e parë e fatkeqësisë së tij u ndie në kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve, kur në njërën nga mbledhjet famëkeqe "për forcimin e partishmërisë dhe të luftës së klasave në letërsi dhe arte", emri i tij u citua ndër ata që fajësoheshin për modernizëm dhe dekadentizëm. Ky ishte vetëm fillimi. Ata që kanë jetuar në atë kohë të egër e njohin mirë shkallëzimin e ankthit, ritmin e rënies së njeriut, shpresat që këputen njëra pas tjetrës, gjersa vjen koha e zbrazët, e vdekur, përpara goditjes fatale.

Maksi i përjetoi të gjitha fazat e këtij ferri. U hoq nga puna në Bashki, u emërua si inxhinier zbatimi në një kooperativë bujqësore jashtë Tiranës, u përgjua me siguri ditë dhe net të tëra. Por e keqja nuk ndalej kurrë në kësi rastesh. Në një mbledhje tjetër të Kryesisë, kur sekretari i pikturës propozoi përjashtimin e tij nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, unë e kuptova se fati i Maksit kishte marrë rrokullimën.

Mbledhja e përjashtimit të tij mbeti në kujtesën time si një gjëmë e zezë. Kryesia kishte rreth 25 anëtarë, shkrimtarë, piktorë dhe muzikantë. Ishte miku im, dhe mbrojtja e tij ishte më e pakta gjë që mund të bëja. Për fat të keq, askush tjetër nuk e mbrojti Maksin. Por mbrojtja ime, pikërisht ngaqë ishim miq, nuk ishte efikase. Duheshin së paku dy-tri zëra të tjerë, që mbrojtja të kishte peshë. Dhe ishte plotësisht e mundur kjo. Mirëpo askush nuk foli. Heshtën në mënyrë të turpshme shkrimtarët dhe muzikantët, ata që e kishin edhe më lehtë të flisnin gjysmë fjale, ngaqë viktima ishte e një sektori tjetër. Heshtën një pjesë e piktorëve, kurse pjesa tjetër foli veç për të derdhur helm.

Maksi u përjashtua nga Lidhja, me fjalë të tjera, u la në kthetrat e diktaturës. A mund të mbrohej? Natyrisht që po. Mbrojtja nuk ishte kaq e pamundur, siç përpiqen ta bëjnë më pas, të gjithë ata që kërkojnë të përligjin larjen e duarve në gjithçka. Në kryesi ka patur raste kur janë mbrojtur aq sa mundej disa shkrimtarë e artistë si Dhori Qirjazi, Sotir Andoni, Koço Kosta etj. Në mos shpëtoheshin plotësisht, mbrojtja e zbuste dënimin, dhe sidomos shmangte burgun.

Pak kohë më pas Maksi, ashtu siç pritej, u arrestua. Në gjyq kolegët piktorë dëshmuan njëri pas tjetrit kundër tij. Shtëpia e tij u bastis. Pikturat iu sekuestruan. Shumica iu grisën e iu dogjën.

Maksi e kaloi në burg një nga periudhat më të rënda të jetës shqiptare. Të kishe shokë në burg në atë kohë do të thotë të ndiheshe dyfish i pasigurt. Të gjithë e dinin se në burg vazhdonte edhe përgjimi edhe hetuesia e mëtejshme, edhe ridënimet. Kështu që çdo natë andej mund të të vinte e keqja. Njerëzit e dinin këtë, diktatura gjithashtu, nuk e fshihte. Ajo e kishte shndërruar burgun në një Hades të vërtetë prej nga vinin kumte të turbullta, si në lashtësi. Përveç mikut tim Todi Lubonja, i dënuar me pesëmbëdhjetë vjet, tani ishte shtuar Maksi. Një tjetër mik i ngushtë, poeti Dhori Qiriazi, ishte ndodhur disa herë në prag të burgimit. Isha i sigurt për besnikërinë e tyre, megjithatë, kush mund ta parashikonte se ç'mund të ndodhte në birucat e errëta, si rrjedhojë e torturave.

Në banesën e projektuar prej Maksit në Rrugën e Dibrës, banorët e njëzet apartamenteve vazhdonin jetën, pa u shkuar mendja se projektuesi i saj ndodhej në burg. Ishte ndërtesa e fundit e projektuar prej tij, pikërisht ajo që i kishte sjellë fatin e keq. Në dhomën time të punës, vendi i oxhakut për disa vjet mbeti si një shenjë e trishtë. (Pas mbarimit të ndërtesës, Maksi kishte ardhur disa herë në apartamentin e ri, por për oxhakun as ai e as unë s'kishim gjetur ende mundësinë ta mbaronim.) Kishim vënë vetëm pikturën e tij "Kënga epike" në pritje, ndoshta, të një kohe më të butë.

Kur kohë më pas, oxhaku më në fund u mbarua, Maksi ishte në burg. Ai bënte pjesë tashmë në pikëllimet e mia. Nuk kisha shpresë se do të vinte dita që të rrinim më në fund pranë këtij oxhaku për të marrë kafenë si dikur, qoftë edhe "me pamje të trishtuar".

E, megjithatë, mrekullia do të ndodhte vite më pas.

Maksi doli nga burgu pas tetë vjetësh. Askush nuk e mori vesh në fillim. Të burgosurit politikë dilnin nga burgu pa zhurmë e si hije. Një ngazëllim i tepërt në shtëpi, vizita të njerëzve ose takime me ta në rrugë quheshin të rrezikshme. Të porsadalët nga burgu për një kohë të gjatë nuk përziheshin me askënd dhe në rrugë nuk i flisnin të njohurve për të mos u shkaktuar fatkeqësi.

Një pasdite isha duke kaluar me time shoqe në sheshin "Skënderbej", kur, të befasuar, pamë Maksin. S'kishte ndryshuar asnjë grimë, kishte në fytyrë të njëjtin pikëllim dhe ecte si më parë, me të vetmin ndryshim se nuk shikonte asnjeri.

Ne i thirrëm "Maks!" dhe m'u duk se mollëzat iu drodhën. U desh një grimë kohe, ndoshta, të kuptonte se ne miqtë e tij po i flisnim vërtet, se nuk kishim drojë ta takonim dhe ta quanim prapë mik, si më parë. Kur i thashë se ia kisha ruajtur "Këngën epike" dhe se mund të vinte ta merrte kur të donte sytë i vezulluan nga lotët. "Të tjerat m'i kanë djegur", tha.



E ftuam që atë mbrëmje në shtëpi dhe ndërsa vërtitej nëpër apartamentin, që e njihte po aq mirë sa unë, dhe sidomos kur u ulëm të merrnim kafenë pranë oxhakut, edhe unë, edhe ai mendonim se diçka ishte thyer në fatalitetin e keq të gjërave dhe se një dritëz dukej, më në fund, në horizont.

Ishte viti 1986. Komunizmi do të binte pas katër vjetësh në Shqipëri.

Paris, mars 1998

Marrë nga "Unazë në kthetra", Onufri, 2004

MAKS VELO DHE ARTET

nga Moikom Zeqo

Vdekja e Maks Velos me pikëlloi. Kujtova me ngulm të hovshëm dhe nostalgjik çastet, takimet dhe bisedat me të. Por është e vështirë të shkruash me një stil epigramatik diçka përfundimtare për këtë artist të shqetësuar si rrallëkush. Maks Velon e kam njohur dhe takuar për herë të parë në vitin 1970. Fytyra e tij mua më kujtoi portretin e poetit amerikan Ezra Paund. Ja thashë këtë gjë Maksit. Vetëm buzëqeshi dhe më tha: "Ndoshta!". Gjatë viteve 1971-1974 takoheshim shpesh, kryesisht në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe artistëve. Maksi pinte kafe pothuajse i heshtur, por kur fliste, në gjestet e tij kishte një pasion të veçantë. Flokët e rritur, mjekra e tij e spikatur përherë dhe më shpesh ma sillnin në mendje të largëtin Ezra Paund, por kjo ngjashmëri më dukej gati e pashpjegueshme dhe një "trill" i natyrës. Nga Maksi mësova për artin popullor të gdhendjes në dru—ai kishte bërë një studim sinkronik , me shumë fotografi të figurinave antropomorfe dhe zoomorfe të gdhendjeve—që mua m'u duk i habitshëm. Kur mua më dërguan pas Pleniumit të IV -për riedukim në shkollën e mesme të Rrogozhinës u kujtova për gdhendjet popullore. Në lagjen periferike të Rrogozhinës ishin shtëpitë e disa familjeve vllehe. Shkoja shpesh atje sepse kisha nxënës të mi nga kjo lagje. Aty u njoha me një njeri 35 vjeç që quhej Vangjel Kanaci, i cili qe bari dhe kulloste një tufë të madhe me dhi në kodrat e qytetit. Më futi në shtëpi, ku pashë i mahnitur një bufe dhe mobilie të tjera të gdhendura në sipërfaqet vertikale me relieve të ndryshme. Vangjel Kanaci kishte bërë në dru bushi shumë skulptura, kryesisht të heroit kombëtar Gjergj Kastiot Skënderbeut, si dhe figura baritore, por edhe mitike si zanat dhe shtojzovalle, qen molosë, buaj, dallëndyshe, një këndes madhështor, por edhe shumë lugë "me birbil në fund", si dhe kokën e heroit partizan Haxhi Qehaj, emrin e të cilit e mbante shkolla e mesme e qytetit. Së bashku me kolegun tim Enver Kushi, bashkëmësues në të njëjtën shkollë, morëm mirëkuptimin e artistit popullor Vangjel Kanaci për t'i paraqitur shumicën e gdhendjeve të tij në një ekspozitë. Ishte Vangjeli që më tha se gdhendjet e tij i kishte admiruar një burrë nga Tirana që quhej Maks Velo. E kam takuar më pas Maksin dhe i kam treguar me fotografi gdhendjet mbresëlënëse. "A m'i jep mua këto fotografi, Moikom, se dua të bëj një album me gdhendjet e Vangjelit?", më tha. Dhe unë iu përgjigja: Padyshim! Por vëmendja e Maks Velos qe përqendruar në një përmasë të artit popullor në dru, pikërisht në ornamentet, që përbënin një pasuri simbolesh të "ngrira" dhe të "balsamosura" në kohë dhe në hapësirë. Në vitin 1998 Maks Velos i dhurova librin tim studimor -në dy gjuhë: në shqip dhe në frëngjisht të quajtur "Onufri" -që ja kisha kushtuar ikonografit më të madh të shekullit XVI. Në faqen 166 të librit tim unë kisha botuar dhe një pikturë në pastel të Maks Velos të bërë në 1961 ku paraqitej studiuesja e ikonografisë, Vitori Puzanova në shtrat,- me të shoqin qe lexonte një libër- Maksi i njihte shumë mirë të dy dhe i kishte pikturuar disa herë. Vitori Puzanova qe ruse në origjinë , kishte lindur në 1893 dhe qe nga një familje aristrokate. Puzanova e shëtitur në Europë,-, e diplomuar për artin bizantin, por mbas revolucionit të tetorit në 1917 erdhi në Shqipëri ku u njoh me një tjetër aristrokrat rus, Vasilin, që kishte lindur në 1894 (qe një vit më i vogël se Vitoria) dhe që vdiq në Tiranë në 30 janar 1964, 70 vjeç. Vasili kishte punuar në Muzeun e natyrësw në Kryeqytet si specialist i balsamosjes. Vitori Puzanova bëri,që në 1949, studimet e para të kishave të Valshit dhe të Shelcanit në Shpat të Elbasanit ku zbuloi për shqiptarët dhe krejt botën piktorin gjenial Onufrin e shekullit XVI. Në librin tim unë e kam quajtur këtë grua "krijuesja e Onufrologjisë". Vitori Puzanova vdiq në 1967, 74 vjeç. Varret e tyre ndodhen ne varrezën e Tufinës pranë e pranë. Për këto varre të harruar, nuk u kujdes askush, absulutisht. I them Maksit që të shkojmë në Tufinë,- t'i gjenim varret. Hipëm së bashku në makinë (në atë kohë unë isha Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar) dhe mbërritëm në varreza - në zyrën ku ruhej harta e pozicioneve të varreve. I gjetëm. Varri i Vasilit qe i rregulluar dhe i modeluar- për këtë ishte kujdesur Vitoria, kurse varri i saj kishte vetëm një pllakë të vogël betoni dhe qe vetëm dhe. Bëmë së bashku, dhe veç e veç, fotografi në varrin e Vitori Puzanovës dhe kur u kthyem në Tiranë shkuam në një restorant, ku hëngrëm dhe pimë diçka. Ishim të dy shumë të gëzuar si në një epifani! Shumë të gëzuar! Kam qenë disa herë në shtëpinë e Maksit, e kam shikuar nga afër pikturën më ngjyra të forta pasteli të Puzanovëve, që unë kisha botuar në libër në formë grafike bardhë e zi. Në shtëpinë e Maks Velos ishte një koleksion i madh vëmëndjethithës - që më kujtonte një kaledoiskop - jo aq simetrik se sa asimetrik,- të rrëmujshëm- si shpella e pikturuar e një asketi të Bizantit. Maks Velo i mblodhi studimet për ikonografinë e Vitori Puzanovës, në një libër të mrekullueshëm- gjë, që e ka bërë vetëm ai. Një nderim i madh,- post mortum! Unë e çmoja Maksin, si një rebel, antikonformist- që kishte bërë një burg absurd në diktaturë, për dashurinë e tij të pakufishme për jetën dhe artin. Një arkitekt i shkëlqyer dhe një piktor i pazakontë. Mua më tërhiqnin në mënyrë të beftë vizatimet dhe krokitë e tij të shpejta dhe tejet lakonike. Një album i Maksit me grafika dhe vizatime nga Parisi më kujtonte mjeshtrit virtuozë të shekullit XX. Maksi qe artist me kulturë,- i prirë për abstragimin e figurave -dhe të simbolizmit të tyre,- nganjëherë ambikuid,- por gjithmonë- të një "estetike lëvizëse". Ai qe edhe shkrimtar, poet, memorialist, por edhe kritik i mirëfilltë për trashëgiminë popullore,- arkitekturën- dhe artet figurative. Maks Velo vdiq në një vetmi vetjake- por jo në një vetmi publike. Ai është dhe mbetet në krijimtarinë e tij, - me letrat kredenciale të shpirtit, të vetëdijes së kurajës- më të epërme,- qytetare,- dhe imagjinatës! Amen!

KORNIZË DASHURIE PËR AUTOPORTRETIN E ERVINIT

nga Virion Graçi

Kam qenë student në vitin e parë te *Filologjiku* kur u botua libri i parë i Ervin Hatibit, *Përditë shoh qiellin,* poezi, Botimet Naim Frashëri, 1989. Ai vetë ishte nxënës në shkollën e mesme, 14-15 vjeç, më duket. Libri menjëherë bëri emër, dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. I vetmi ent botues në Shqipëri për librat artistikë atëherë ishte "Naim Frashëri"; I vetmi mjet me të cilin shqiptarët mund të mbushnin/trazonin veten shpirtërisht çdo orë të ditës, çdo ditë të javës ishte libri; e libri, siç e dimë, aso kohe qarkullonte në tirazhe mijëra kopjesh në çdo qendër të banuar të vendit sepse kudo kishte librari e lexues, kudo, në çdo shkollë e njësi banimi kishte biblioteka publike me libra për çdo moshë; libri *Përditë shoh qiellin* bëri histori pa dalë ende në librari- ishte shoqëruar me parathënie nga Ismail Kadare, çka do të thoshte shumë për publikun, premtim i madh, krahas moshës fare të re të autorit. Të jem i sinqertë, ende nuk e kam lexuar atë libër, atë botim. E humba mundësinë ta lexoja në kohë reale, me të tjerët, pastaj, peng i një zakoni tim të pandreqshëm, kur nuk e bëj dot diçka në kohën e duhur, nuk i kthehem kurrë më vonë. Por në mendjen time vërtitej herë pas here emri i autorit dhe nuk u dredhoja bisedave kureshtare e fjalëve premtuese që thureshin rreth tij. Ishte për t'u pasur parasysh me kërshëri pozitive fenomeni Hatibi, mendoja qysh atëherë. Sepse ishte adoleshent kryeqyteti, i kulturuar e nga familje me kulturë, nuk ishte i detyruar të bënte poezi për t'u ngjitur më lart në shoqëri, për llogari pragmatike, për t'u zyrtarizuar, për të bërë karrierë e për rrjedhim – rehati familjare afatgjatë në kryeqytet, në ndonjë zyrë shtypi a botimesh; E. Hatibi, adoleshenti i talentuar e përnjëherësh i njohur, i famshëm, meritonte respekt e vëmendje sepse nuk ishte nga zbulimet me dorë në zemër e mallëngjim në sy që burokratët kryesorë të Lidhjes së Shkrimtarëve e Artistëve të kohës bënin nëpër qyteza e katunde gjatë turneve të tyre kulturorë-gastronomikë a në kuadër të qëndrimit gju më gju me popullin, sipas modelit të vetëm të epokës totalitare. Nuk vonoi, dëshira ime për ta njohur njeriun Ervin u përmbush; erdhi student në degën tonë, kishte miqësi me shok të kursit që rrinin konvikteve; vinte përherë, sillte për të gjithë libra të ndaluar dhe atmosferë hareje, gazmendi; takimi ynë ndodhi ashtu si e kishim dashur të dy, rastësisht, mes miqve të përbashkët, duke shmangur bisedat didaktike-teorizuese për letërsinë, për poezinë, për procesin krijues e të tjera nga këto. Gjëja e parë që i kam thënë ishte: "Vino, nuk e kam lexuar ende librin tënd, atë me *qiell*". Ai sikur u çlirua nga një bezdi e madhe dhe kjo e bëri më të çlirët marrëdhënien tonë.

Ishte i zhvilluar para kohe, jo vetëm fizikisht; kulturalisht, me interesa në muzikë, në poezinë botërore, në pikturë; por shenjën më të pëlqyeshme të pjekurisë së tij të parakohshme e vëreja te largësia higjienike që mbante me ngjarjet e kohës, me masat, me turmat, me autoritetet, me grupimet e rrethet e organizuara, të strukturuara, qëllimore. Spontaniteti ishte virtyti dhe shpëtimi shenjtërues i atij shpirti aq të dëlirë e shpërthyes. Ishte nga kërthiza e vendit, tiranas nga familje tradicionale, ishte kozmopolit për nga formimi e shijet sepse kishte ndjekur e asimiluar gradulisht thuajse çdo gjë të mirë e me vlerë që kishte kapur në fshehtësi; ishte fizikisht pranë të ngjarjeve që po shkundnin vendin, establishmetin, autoritetet dhe institucionet e sistemit politik-shtetëror; kishte njohje direkte, të mëherëshme e të natyrshme me gati çdo njeri të brezit të tij që po bëhej protagonist shkëlqimplotë në ngjarjet e vrullshme të atyre muajve/stinëve/viteve; mund të ishte në krahun e gjithkujt si i barabartë, pa mbetur në hije, pa mbetur në plan të dytë, por zgjodhi të mos trazohej me tribunat e as me turmat me të cilat deheshin tribunat, në kuptimin e plotë të fjalës. Me sa kam kuptuar, kishte vënë bast me veten e tij për gjërat që i kishte të brendshme, të çmuara, të dashura, dhe ato vetë i kishte lënë të rriteshin e të kristalizoheshin ngadalë, me radhë, si t'u vinte ora. Nga ana tjetër, bashkë me letrarë e aktivistë të tjerë të moshës së tij si Rudi Erebara, Rudian Zekthi, Agron Rexha, me përkujdesje për letrarë të tjerë që nuk kishin njohje e botime të mëparëshme, qëmtonin dorëshkrime e fletore shokësh për krijime të vlefshme, për ta pasur një vëllazëri letrare, për ta pasur një forum të ri, një gazetë, për të mos u falur në *kishë* t*ë vjetër*, për t'u ndarë nga institucionet hijerënda të kulturës e të editorisë së kohës, shtetëroret e privatet, tashmë. U bë botuesi e promovuesi ynë, ndonëse një 5 vjeçar më i ri se ne në moshë. Aventura e Ervin Hatibit prej redaktori botues u kurorëzua me krijimin e gazetës letrare-kulturore "E PËR-7-SHME" në faqet e së cilës gjetën vend punimet/krijmet e spikatura të mjaft poetëve dhe eseistëve rishtarë. Si ç'do ëndërr e bukur, as ajo nuk zgjati mjaft, por, gjithsesi, gazeta meteorike e Ervinit, Rudianit, Rudit ishte një dritë, një llampë e ndezur në kaosin dhe rrëmujën e kohës rreth së cilës u mblodhëm si flutura, pa na u djegur krahët, na mundësoi të njihemi e të miqësohemi me të tjerë vëllezër të penës e të fateve të ngjashme.

Për fat, udhëtimi artistik i Ervin Hatibit vazhdoi me libra poetikë. Në 1994 botoi *6 Maç*, (poezi); *Pasqyra e lëndës*, poezi, 2004; *Republick of Albanania*, publicistikë, 2005, etj. Natyra e poezive të E. Hatibit është gjerësisht e njohur; miq e dashamirës të tij shpesh shpërndajnë poezi e poema të tij, në raste të ndryshme. Përkufizimi i saj është i lehtë, sikurse është e lehtë të gjesh fjalët e duhura përcaktuese për vepra me fizionomi të qartë artistike, me origjinalitet të spikatur, me formë e ligjërim poetik krejt origjinal, pa një pararendës a model të përafërt, të paktën në traditën tonë poetike.



Prandaj mjaftohemi duke thënë se poezia e E.Hatibit është poezi e një revolucioni estetik, ajo rrëfen në kufijtë e një proze poetike; ajo parodizon në kufijtë e një tregimi satirik; ajo demistifikon mite, ambiente, ideale kallpe me të njëjtën energji e vrull me të cilat braktis format tradicionale, të afërta e të largëta të poezisë shqipe, të leksikut poetik, të sintaksës. Vetëm një shpirt i pastër fëminor si ai i Ervinit mund të shkaktonte kaq rrëmujë e goditje antikonformiste në letërsinë e në shoqërinë shqiptare të kohës dhe, paradoksalisht t'i gëzonte të gjithë, njëkohësisht, pa shkaktuar dhimbje, fyerje, irritim. Askush, publikisht a privatisht, sa di unë, nuk e anatemoi poezinë e tij të pas viteve '90, ndonëse ajo na fshikullonte të gjithëve nga pak. Sa për kujtesë po sjellim vetëm njërën:

Ç›BËJNË PIJANECËT

e pra ç›bëjnë
pijanecët
gjatë kohës
së lirë
e cila nuk është
edhe aq e lirë
por në kohë robërie
vëlla...
e pra ç›bëjnë
pijanecët
në këtë
kontradiksion
brenda kohës së lirë
e cila shtrenjtë
është ndryrë
brenda kohës së robëruar
pijancët
gjatë kohës
së lirë
shkruajnë poezi
e gjeta
këta janë poetët
një, dy, tre
dy e nga dy
tre e nga tre
një, dy, tre
një e nga një
ata plotësojnë
antologjinë
e poezisë
shqipe.
(përjashtohen nga kjo poezi
ata që e bëjnë me qëllim)
1994

Një fushë tjetër në të cilën u shqua E. Hatibi ishte publicistika, edhe ajo nën shenjën e ironisë, groteskut, në kufijtë e skicës humoristike a të satirës politike, jo rrallë. Ishte koha kur gazetat dhe mediat e reja, private, të pa varura u përmbytën me kujtime e dosjerë nga historia taze e diktaturës, nga blloku udhëheqës komunist, nga gjithëfarë profanësh për të cilët nuk kishte temë a dukuri për të cilën nuk mund të shpreheshin, ashtu, në mënyrë profane, në mënyrë të vrazhdë, pa thellësinë e përgatitjen e duhur diturake e shkrimore. Ervini ishte ndër ata pak zëra që iu kundërvunë haptas kësaj balte mediatike, gjithologe, mercenarë të maskuar e egocentristë të etur për pagesa e për skupe mediatike. Dy qasje ka pasur E. Hatibi ndaj tyre, e para, nëpërmjet shembullit të vet shkrimor, krejt i kundërt për nga cilësia e standardet me shkrimet e gjithologëve, së dyti, duke polemizuar direkt me ta për çështje të ndjeshmërisë historike, fetare, kulturore…

Nga shembujt më tipikë të rrëfimit autobiografik-eseistik po sjellim shënimin e mëposhtmë, Ervini fëmijë, nga familje me 'biografi te keqe', si "pionier i Enverit" në takimin e udhëheqjes me pionierët e dalluar gjendet në shkrimin me titullin: *Ju rrëfej takimin*

tim me Nexhmie Hoxhën: "...një errupsion fëmijësh rrethoi hyrjen e Ramiz Alisë. Një pionier nga veriu, i veshur me kostumin tipik "bardhë-zi-kuq", qeleshe përfshirë, kishte recituar një strofë të posaçme në dialekt për xhaxhi Ramizin dhe pastaj "hopa" iu lëshua xhaxhi Ramizit si kamikaze në një përqafim violent fluturimthi. Xhaxhi Ramiz gati sa nuk u thye në mes. Dy-tre shoqërues rendën ta shkëpusnin si midhjen nga guacka fëmijën-malësor që nuk shkulej nga xhaxhi Ramiz dhe dikur ia arritën kësaj. Filloi shpërndarja e buqetave me lule: targeti ishte përsëri xhaxhi Ramiz por dhe udhëheqësit përreth që i ngjanin nga pamja e sigurisht nga veshja. Kisha mbetur si i hutuar me lule në duar kur mes tallazisë shquaj nga larg konturet e një gruaje të veshur me të zeza, mbetur ca më larg grumbullimit. Ishte Nexhmie Hoxha, një grua të cilës atë vit sapo i kishte vdekur burri. Nuk e pata vështirë ta lejoj magnetizimin të më transportojë drejt saj dhe t'i dhuroj tufën time me lule, të vetmen. Ajo i mori lulet dhe tha zëulët diçka që duhet të ishte falenderim. U ndjeva i realizuar. I mirë. Vërtetë, gratë sidomos, ma kanë këputur përherë shpirtin. ("Republick of Albanania". f.23.)

Ervini-poet iu përkushtua jo pak luftës ndaj banalitetit, falsitetit kolektiv e individual, heronjve pa krena, qytetit pa qytetari, metropolit pa fizionomi qytetare, provincializmit, modeleve të reja të jetesës gjasme boheme, gjasme moderne; ai i stigmatizoi ato duke i bërë lëndë të parë në ligjërimin e tij poetik-rrëfimtar e parodizues. Të njëjtën mungesë delikatese e mëshire, të njëjtin ton e të njëjtat linja baroke përdor edhe kur portretizon vetven në mes të shoqërisë. Në shkrimin *Poeti pesëmbëdhjetë vjeçar* E. Hatibi ka bërë një autoportret, atipik në llojin e autoportreteve, në fakt, ka shpërbërë e refuzuar atë aureolë nderimi e lavdie të parakohëshme që gëzonte qysh adoleshent si poet, si talent i rrallë i letërsië shqipe, sipas dokumentarit të kinostudios "Shqipëria e re": "Pas më se një dekade të shohësh përsëri një film vetëm me një personazh. Ballë për ballë. Ky personazh isha unë gjatë verës së vitit '90. Pra unë pesëmbëdhjetë vjeçar. Fytyra ime arkeologjike, si një kartpostale e zhubrosur në xhepat e viktimave, zbuluar nga poshtë rrënojave ngjyra-ngjyra të gjithë atyre viteve; janë në fakt edhe puçrrat e mirënjohura të pubertetit që rrotullohen rreth portretit, jo vetëm sklepat e skelerozës kormatike të filmit gjermanolindor. Ky fëmijë është ai që ka humbur; kush ta gjejë ta vendosë te befotrofi I sendeve të humbura që dhembin. Trishtim apo turp? Ke vënë kujën, kujë që e ndjejnë vetëm lexuesit e përndjekur të poezisë shqipe, ke venë kujen për ikjen e fëminisë, e ja ku ta sjellin përpara syve e ti s'di ku të futesh. Fëmija i *Rai uno*-s dhe *Kronikës n*ë *gur*, dhe fëmija i ponçit të portokallit dhe agjitacionit e

propagandës, fëmija i fletores ambulante me përkthime nga Remboja, pantallonat e tij prej doku bojëqiell dhe zëri i zvargur si prej halle beqare; ma hiqni sysh bastardin. Jo, jo sille kokën bir, më jep lot të qaj, etj, etj. Por ama dhoma e fëmijës ka në mure një portret të ujdisur në formë zemre: është portreti i Karl Marksit ("...një portret i Karl Marksit i varur në mur/babën e pyes a u lodhe he burr..."-rok-grup Minatori). Pastaj fëmijën e zgjedhur e pyesin intervistuesit pas kamerës së dokumentarit të kinostudios, e njëjta që ka xhiruar me hollësi të turpshme barinj, dele, torno e piramida kufiri, e pyesin për poezinë dhe ai thotë: Naimi, në çdo shtëpi duhet ta kishim një portret me Naim. Kur u rrita edhe pak e kuptova se do të më shqyente kjo dashuri: këtej Marksi e andej Krishti. Historia ime e viteve nëntëdhjetë është historia e Alzasë-Lorenës.... ("Republicka of Albanania", f.239-240)

Qëndrimi i tij realist, modest, esëll përballë multiplifikimeve të kritikës a historianëve letrarë merr një vlerë të madhe kur kthen në normalitet ndodhitë dhe pandehmat për zhvillime letrare avanguardiste e post-moderniste të fillimeve të viteve '90, ku ai vetë, në fakt, do të ishte ndër përfituesit kryesorë si poet i dalluar dhe protagonist i vijës së parë, me cikle poezish, mbi libra, me gazetën "E PËR-7-SHME". E. Hatibi, me argumenta teoriko-letrarë iu shkon ndesh teprive, i jep vetes (dhe kolegëve e vëllezërve të tij të lirës poetike) vetëm atë që është e Cezarit, dmth, më pak nga çfarë rëndom na atribuohet edhe në mjedise shkencore, universitare. Veçojmë: "Duke kaluar përmes surrealizmit, dadaizmit, agjitpropit, simpative për jogën e rock-un agresiv, "E PËR-7-SHME" konturoi fytyrën e saj prej fetishi e pastaj vdiq për mungesë fondesh. Siç ndodh në të tilla raste. Ky ishte dhe mesazhi më i fortë, ky ishte numri vijues i saj. (Vijon edhe sot). Arti është akt vetësakrifikimi e vetdenoncimi, etj, etj. Me pak fjalë është krenari dhe qëllim në vetvete: të humbësh. E "PËR-7-SHME" nuk ishte gazetë por mbase një dekor teatral i një drame a një letër dashurie në prag të parandjenjës së keqe." ("Repubicka of Albanania", f.209)



Ngado që ta shikosh sjelljen dhe prurjet e deri tashme të Ervin Hatibit në letërsinë dhe shoqërinë shqiptare, do të gjesh veç vlera të rralla, humanizëm, origjinalitet, sinqeritet. Për poezi të shokëve që i pëlqenin më shumë shprehej: "e kemi të bukur këtë poezi." Nuk e kam hasur gjetkë, përveçse te Ervin Hatibi një mirësi e gëzim të tillë të dëlirë ndaj asaj që nuk të përket si autorësi, por të prek në shpirt si lexues.

"Kujtimet janë shtresa jo prodhimtare, në përgjithësi, ndaj shoqëria, ashtu si pleqtë në azile, i ka mbyllur në ndonjë datë të kalendarit," shkruan diku Ervini. Natyrisht, e ka fjalën për kujtimet e ndihmës së shpejtë me të cilat përpiqemi të gjallërohemi sentimentalisht, të ridimensionojmë të shkuarën në përpjekje për të madhëruar veten në krahasim me të vërtetën, në mos në mënyrë heroike, të paktën si alibi, si sfumim i dekoreve e aktorëve të tjerë bashkëkohës që mund të na nxjerrin në plan të dytë. Shfletimi rilexues i krijimtarisë së deritashme të Ervin Hatibit është endje estetike, gjallërim i mendimit, gjetje e hallkave të këputura të kujtesës nëpër zhurmat jo produktive të kohës- e sigurt kjo, sikurse është e sigurt parandjenja jonë dëshirore se Ervini do të rikthehet në letërsi së shpejti, me poezi dhe në prozë duke bërë të tjera poezi e poemtha, skica, polemika, portrete e autoportrete për të na shpëtuar e lehtësuar sado pak nga patetizmi, nga protagonizmi monologues, shterpë, nga iluzionet letrare dhe nga mirazhet e shkretëtirës sonë urbane.

"LUMTURIA MARTESORE", NJË VEPËR E PËRSOSUR RASINIANE

Nga Romain Rolland

Nga ajo periudhë kalimtare kur gjenia e Tolstoit po hapte verbërisht rrugën e tij, dyshues ndaj vetes dhe në dukje i ligështuar, "pa pasionin e fortë, pa vullnetin që ta orientojë", ashtu si Nehludovi te *Ditari i një shënuesi*, lind vepra më e kthjellët që ai ka krijuar ndonjëherë: *Lumturia martesore* (1859). Kjo është mrekullia e dashurisë.

Për shumë vjet, Tolstoi pati marrëdhënie miqësore me familjen Bers. Ai kishte rënë në dashuri herë pas here me nënën dhe të tria vajzat e saj. Përfundimisht, zgjodhi të dytën, por nuk e pati guximin t'ia shprehte dashurinë. Sofia Andrejevna Bers ishte ende fëmijë, shtatëmbëdhjetë vjeçe; Tolstoi ishte mbi tridhjetë dhe e quante veten një plak që nuk kishte të drejtë ta lidhte jetën e tij prej mëkatari me një vajzë të re e të dëlirë. Duroi për tre vjet. Më vonë, tek *Ana Karenina*, ai na tregon se si ia shprehu dashurinë Sofias dhe se si ajo iu përgjigj: të dy shkruan me shkumës germat e para të fjalëve që nuk guxonin t'i thoshin me zë të lartë.

Ashtu si Levini tek *Ana Karenina,* ai u tregua çmendurisht i sinqertë sepse ditarin e tij intim e la në duart e së fejuarës, që ajo të mësonte të gjitha mëkatet e së kaluarës së tij; dhe Sofia, ashtu si Kiti tek *Ana Karenina*, vuajti pikëllueshëm. Ata u martuan më 23 shtator 1862.

Në përfytyrimin e shkrimtarit, kjo martesë ishte konsumuar tre vjet më parë, në kohën kur shkruhej *Lumturia martesore*. Gjatë këtyre viteve ai kishte përjetuar dhe shijuar më herët vuajtjen e ëmbël të dashurisë së pashprehur dhe ditët dehëse të dashurisë së pranuar; orën e mezipritur kur pështpëriten fjalë hyjnore; lotët që rrjedhin "prej lumturisë që ikën përgjithmonë dhe nuk kthehet më kurrë"; realitetin triumfues të ditëve të hershme të martesës; egoizmin e të dashuruarve; "gëzimin e pashkak e të përhershëm dhe harrimin e çdo gjëje në botë"; më pas lodhja që afrohet, pakënaqësia e vagëlluar, mërzia e jetës monotone, dy shpirtra që shkëputen butësisht dhe largohen nga njëri-tjetri; magjepsja e rrezikshme e jetës mondane për nusen e re – flirtet, xhelozitë, keqkuptimet fatale, dashuri të fshehura, të humbura; dhe pas një kohe të gjatë, vjeshta e trishtë, e dhimbshme e zemrës; fytyra e rishfaqur e dashurisë, e zbehtë, e vjetruar, por më prekëse prej lotëve dhe rrudhave të shtuara; kujtimet e trazimeve, pendesa për veprimet e pamenduara si dhe për vitet e humbura; qetësia e mbrëmjes; kalimi augustian i dashurisë në miqësi dhe i pasionit dashuror në amësi... Të gjitha këto priteshin të ndodhnin, por të gjitha këto Tolstoi i kishte ëndërruar, i kishte shijuar para kohe; dhe që t'i përjetonte edhe më gjallërisht përmes këtyre ditëve, ai ka jetuar tek ajo, tek e dashura e tij. Për herë të parë – e ndoshta të vetmen herë në gjithë krijimtarinë e tij – romanca zhdrivillohet në zemrën e një gruaje dhe rrëfehet prej saj; dhe me çfarë finese! Ç'bukuri shpirtërore e mbështjellë me një vello droje! I vetmi rast ku analiza e shkrimtarit nuk është therëse; ai nuk synon ta shpalosë të vërtetën në gjithë lakuriqësinë e saj. Të fshehtat e botës së brendshme zbulohen, ato nuk thuhen. Arti dhe zemra e Tolstoit janë të mallëngjyera. Drejtpeshim harmonik i mendimit dhe formës. *Lumturia martesore* ka përsosmërinë e një vepre rasiniane.

Përkthyer nga Bujar Hudhri



FIJE TË NATËS

poezi nga

Paul Celan

Shqipëruar nga Vangjush Ziko

(Fije të natës)

Prej zemrave dhe truve
rriten fijet e natës
dhe fjala me urtësinë e saj
i përkul nga jeta.

Në heshtje, si ato,
ne i shkojmë në takim botës:
shikimet tona
këmbehen, për mëshirë,
me tamin ecim
pas shënjave të tyre të errta

Pa ndriçim
heshtin sytë e tu në të mitë,
duke u endur,
ta sjell zemrën tënde te buzët,
dhe ti zemrën time ma sjell:
kjo që ne po pimë tashi
shuan etjen e orëve,
ato që po hamë tashi,
ngopin orët e kohës.

I rrënojmë ato?
As zë, as gjurmë:
nuk kemi përgjigje mes nesh.

O fije, kallinj,
ju, fije të natës.

Alkimi

Heshtja si ar i shkrirë në
thëngjijtë
e pëllëmbëve.

Ngjyrë hiri, i madh
i afërt, si çdo gjë e hunmbur,
imazhi i motrës:

Të gjithë emrat, të gjithë
emrat të djegur.
Sa hi për bekimin e tij.
Sa tokë e nënshtruar
nën
unazat e lehta
të lehta të shpirtit.

Ngjyrë hiri. I madh
sa nuk e nxë vendi.

Ti atëhere ishe
e venitur
but i pjekur
i mbytur me verë.

(A s'ndodhi kështu? Dhe ne
na çliroi ky çast?
Qetësisht
qetësisht vdiq fjala jote këtu.)

Heshtja e shkrirë si ari
në thëngjijtë
thëngjijtë e pëllëmbëve.
Gishtat si tym që shkon
si kurora, aureola
mbi - -

Ngjyrë hiri, i madh,
pa gjurmë
mbretëror.

Kristal

Mos e kërko gojën tënde te buzët e mia,
Në portën e të ardhurit,
Në sytë e lotëve.

Më tej se shtatë netë bashkohet e kuqja me të kuqen,
Shtatë zemra më thellë troket dera në portë,
Në shtatë trëndafila llokoçitet më pas pusi.

Në Egjypt

Të huajës thuaja në sy: Ti je uji,
Ji ujë.
Duhet që atë që njeh në ujë,
ta kërkosh në sytë e së huajës:
Nuk duhet t'i thërresësh prej ujit: Rufi!Noem! Miriam!
Duhet ta stolisësh të huajën, kur shtrihesh në shtrat
me të.
Duhet ta zbukurosh atë me renë e flokëve të saj.
Duhet t'i thuash Miriamit, Noemit dhe Rufit:
Shikoni, unë po shtrihem me ju.
Duhet ta stolisësh të huajën me të cilën je shtrirë.
Duhet ta zbukurosh atë me dhimbjen e vet: O Ruf!
Noem! Miriam!

Duhet t'i thuash së huajës:
Unë jam shtrirë me ato!

Kush është si ti

Kush është si ti që pëllumbthin e ditës dhe të hijes e
krijon nga errësira
çukit yllin e syrit përpara se të ndritë
në qerpikët cimbis fijet e barit përpara se të piqen
flakërin dyert në retë përpara se unë të futem

Kush është si ti që gjithë karafilat e gjakut i flak si
monedha
i gëllti si verë
kush fryn pëllëmbët e mia dhe bën gotë për vete
dhe e copëton pas gurit të një loti

Ditën

Qielli si lëkurzë lepuri. Dhe përsëri
pena shkruan qartë.

Dhe unë, kujtohu,
ngjyrë pluhuri
a nuk erdha si lejlek.

Citate të kredos poetike të Celanit:
Poezia është shndërrim ndryshe i pikëllimit "unë" .
Poezia nuk është një njoftim, është transmetimi i
vetvetes...Unë nuk shikoj ndonjë ndryshim themelor
midis një shtërngimi dore dhe poezisë.
Poezia, si domozdoshmëri veprimi dhe ekzistence.

MONOLOGJE

nga

Shazim Mehmeti

MONOLOGU I POÇIT

Jeta ime është varje.

Siç e dinë të gjithë, unë jam i varur për një tavani të bardhë. Frymoj, gjithnjë atje, me frymën e asaj bardhësie shoqëruese. Jeta ime është sipër, është veç. Vetmia është fati im.

Gjithë ditën e ditës, prania ime s'i bie ndërmend kurkujt. Gjithë ditën e ditës, jam i fikur, e nuk shoh gjë. Sytë e mi vuajnë nga verbëria e ditës, nga verbëria e dritës. Siç e thashë më sipër, vetmia është fati im.

Duke qenë gjithnjë i vetmuar dhe i verbër përgjatë ditës, kam fituar një afinitet të çuditshëm për ndjesinë e prekjeve, që më ndodhin rrallë, rrallë, shumë rrallë. Përjetoj shumë thellë, kur vjen e më prek ndonjë mizë vërvitëse, që e shoqëron herë pas here vetminë time ditore, duke u kruar në lëmueshtinë time qelqore.

Gjithë ditën e ditës, njerëzit e shtëpisë nuk çajnë kokën për mua e për praninë time. Përgjatë gjithë ditës, unë gjumin e vdekjes bëj.

Por, kur perëndon dita e dielli ik për në gjumë, sytë e njerëzve fillojnë të rrudhosen nga terri dhe sakaq kujtohen për mua. Gjithnjë, gjendet dikush që kujtohet i pari të zgjasë dorën drejt ndërprerësit të shpirtit tim, që rri atje, në murin e bardhë dhe vertikal.

Ahere, shpirti im merr udhë drejt meje, sytë e mi hapen me një faaaap, dhe kështu fillon jeta ime dritësore. Kështu filloj të shoh përposhtë, përposhtë. Shoh larat mbi qylymin e dhomës, palëvizshmërinë e tyre të vdekshme. Shoh orenditë e ftohta, pikturat pa fare shpirt, mbi muret e bardha... Shoh gjësendet që gjithnjë rrinë gatitu përpara njerëzve. Shoh tiraninë e hekurt të njerëzve mbi gjësendet dhe mbi veten. Shoh disciplinën pothuajse ushtarake në jetën normale, dhe dëshpërohem, dëshpërohem shumë.

Nga ky dëshpërim tmerrak, dal vetëm kur i shoh duart e zonjës, me gishtat e saj të bukur e të njomë... Vetëm prekja e rrallë e duarve të zonjës së shtëpisë (kur vjen e ma heq pluhurin), më shpie në orgazëm.

Por, përse kaq pak pluhur bie mbi mua, dhe ajo ma heq aq rrallë?!...

MONOLOGU I ZJARRIT TË VOGËL NË FUSHËN E MADHE

Kam shumë epsh, shumë etje, shumë zjarrmi.

Pasioni im i zjarrtë është flakërimi. E shikoj këtë fushë të gjërë përpara e përreth meje, e lëpij këtë bar të gjelbërt me gjuhët e mia të vogla, e digjem për ta djegur të tërën.

Siç duket, e siç më duket, edhe kjo fushë, ka një ankth gllabërues e të gjelbërt brenda vetes, që s'dihet ç'është. Por, ai ankth gllabërues i fushës, është i dukshëm dhe i pafund. Unë e ndjej këtë. Unë e kuptoj këtë përmes gjuhëve të mia flakëruese. Çasti i përprekjes sime me fijet e barit, ma pohon këtë. E pafund është dëshira e fushës për t'u djegur. I pafund gjakimi. I pafund dhe i pa masë, si epshi im për djegje.

Tash për tash, unë e kjo fushë, jemi në një lloj paqe të kontrollueshme. Unë jam shumë i vogël, ajo e madhe shumë. Por, sa për më vonë, asgjë nuk dihet.

Sipër meje e sipër fushës, ka një qiell të hapur e të kaltërt, një qiell nazik e të këndshëm, me një kaltëri të tillë, që nga çasti në çast mund të marrë msyshë.

S'do menduar shumë thellë, e s'do menduar shumë gjatë: ky qiell kaltërosh është në rrezik të vërtetë dhe trefishor: nga dëshira e ime e pafundshme për ta djegur fushën, nga dëshira e pafundshme e fushës për t'u djegur prej meje, dhe, nga pasioni vetanak qiellor i pafund, për të parë përballjen e zjarrit që djeg, dhe zjarrit që digjet.

Këtë qiell paqësor (që për fat të keq ose të mirë, edhe ai është shumë i etur për të parë një përballim përndezës mes meje e fushës), mund ta shpëtojë nga përzjarrmimi, vetëm një gjë: ajo reja e vogël, e vogël, që mezi duket atje lart, në zemrën e vet qiellit. Kuptohet, nëse nuk ka rënë akoma, edhe ajo, në vrullin e zjarrtë të pasionit, për të parë përballimin e gjuhëve të mia epshore, me epshin pafundsor të fushës...

MONOLOGU I LISIT TË VETMAR NË FUSHËN E GJËRË

Fusha ku i kam rrënjët unë, quhet Karagaq. Kjo fushë është e gjërë dhe e shtrirë, dhe dominohet prej një klime shpezësh. Klima e shpezëve, siç mund ta dini të gjithë, është këngë. Që domethënë se është një klimë e mirë dhe e përshtatshme për jetesë.

Por, ç'e do klimën që është e mirë, kur unë kam mbetur krejt i vetëm në këtë fushë të gjërë, pa shoqe, pa shokë.

Ja si tani, shpesh më ndodh të flas me veten, por edhe me erën, që herë pas here di të bëhet shumë e egër me mua. Për fatin tim të keq, unë jam i vjetër me moshë, dhe shumë i gjatë me shtat. Kryqet e trupit, edhe krahët, shpesh herë më kërcëllojnë gjithë dhembje, nën furrinë e erës.

Por, se si më duket, se shpirtin e kam të ri. Këtë e kuptoj nga ndjesia që më krijohet, kur në krahët e mi ulen shpezët. Apo thënë më saktë, këtë e kuptoj nga xiglimet ndjesore që ngjallen brenda meje, kur majëkthetrat e shpezëve m'i përprekin degët.

Siç mund ta kuptoni nga kjo që ju thashë më sipër, këto xiglime janë bërë disi, pjesa më e bukur e jetës sime lisnore.

Kjo fushë përreth meje, punohet prej njerëzish. Por, përgjatë gjithë jetës sime, rrallë më ka ndodhur të shoh njerëz të lumtur e të buzëqeshur. Gjithë ata që vijnë e bëjnë punë këtej, janë me ca fytyra të ftohta, dhe dëshpërimisht të mrolura.

Me shpezët është ndryshe. Me gjasë, shpezët kanë një mënyrë tjetër jetese, që edhe ajo është e ndryshme, varësisht nga lloji i shpezëve. Pëllumbat, për shembull, janë gjithnjë të qeshur e të gëzueshëm. Kjo, nuk është e zorrshme të shihet në gugutë e tyre dashurore. Me sa më duket mua, pëllumbat dashurojnë e dashurohen shumë, dhe dashuria e tyre bëhet me një lloj përprekje qafash e sqepësh, butë e pa lëndime. Ndryshe nga pëllumbat, sorrat dashurojnë e dashurohen disi më ftohtë. Bufët, edhe më ftohtë. Lejlekët janë krejt ndryshe. Ata nuk bëjnë dot dashuri jashta foleve. Me gjasë, janë shumë të turpërueshëm lejlekët. Më me zjarr, më me gjak, e më me përgjakje, dashurojnë e dashurohen shqiponjat. Për kaq jetë, sa jam me rrënjët e mia në këtë fushë, nuk më ka ndodhur të shoh dashuri shqiponjash pa gjak e pa plagë.

Sido qofshin, me gjak e pa gjak, me plagë e pa plagë, dashuritë e shpezëve janë, shumë, shumë joshëse. Dridhem, rrënjë e degë, kur i shoh shpezët si dashurojnë e dashurohen. Digjem përbrenda, për një përprekje t'atillë.

Por, ç'e do, kur jam, vetëm një lis i vetëm në këtë fushë, ku nuk ka lis tjetër. Ndaj, s'më mbetet tjetër, veçse t'i shkoj prapa fatit tim të parashkruar: me majën time ndjesore, të depërtoj përjetësisht në vaginën e qiellit dashuror.

MONOLOGU I MERIMANGËS SË ZËNË, NË SKAJIN E SIPËRM TË NEVOJTORES VERORE

Jemi, një soj i rrallë, ne merimangat. Vërtet jemi disa llojesh, për nga madhësia e për nga konstrukcioni trupor, por, një veti e kemi shumë të përbashkët: digjemi nga pasioni jonë, për të thurrur rrjetë e për të gjurmuar e hetuar, me sytë tanë të vegjël, në jetët e njerëzve. Digjemi, siç digjen zogjtë e malit, për të parë si bëjnë dashuri lepujt.

Misioni apo detyra jonë, për të hetuar në jetët e njerëzve është punë shenjti. Në të shumtën e herëve, apo pothuajse gjithnjë, ne i ngrisim rrjetat tona pikërisht në këndet e sipërme të kthinave banuese. Që andej, me përimtësi, ne shohim e lexojmë gjithë lëvizjet e njerëzve, fytyrat e tyre, trupat e tyre, gjymtyrët e tyre... Kështu dhe vetëm kështu, ne lexojmë pa vështirësi edhe në ndjenjat e tyre, e në mendimet e tyre. Dhe kënaqemi, e kënaqemi, e kënaqemi, me punën tonë, e me misionin tonë prej merimangash, sidomos, kur vemë e raportojmë atje lart.

Por, këso here, jam zënë tepër keq, në rrjetën time.

Jam zënë keq, pikërisht në skajin e sipërm të kësaj nevojtoreje verore, që është e ndërtuar në skajin e oborrit të shtëpisë së këtyre njerëzve. Pres, e pres. Por kot! Nuk e hap njeri derën e kësaj nevojtoreje. Vera është tepër e nxehtë, tepër përcëlluese. Kjo nevojtore ku jam e zënë, për çudi, frekuentoheshka shumë rrallë nga familjarët, ose fare. Mbase, pse kjo familje është e vogël, vetëm katër anëtarëshe, me një zot shtëpie që..., me një zonjë shtëpie që..., me një

çun pubertetli që..., dhe me një çupkë pubertetlie, që poashtu...

Eh, u lërofsha nënën të gjithëve! Ua lërofsha dhe që...-të atyre!

Pyes veten: pse vallë, kjo familje qenka e tillë? Verë është, e, askush nuk e bën nevojën në nevojtoren verore!... Aq pata shpresuar, e...kot! O, çudi, çudi!

Që nga çasti që jam futur në këtë kënd rrjetor, nga të zotët e shtëpisë, u mbyllën edhe dera edhe dritarja e nevojtores. Jam e zënë dyfish këtu: në nevojtore, dhe në rrjetë. Kështu si jam e zënë në nevojtore e në rrjetë, kam shumë hamendësime, që prej sa e sa ditësh më torturojnë. Por, më shumë se hamendësimet, më torturon uria. Burgu im më i vërtetë, është kjo rrjetë që vet e thurra me gjymtyrët e mia.

E pabesueshme, por unë, në këtë kënd nevojtoreje, jam zënë edhe nga një kurreshtje personale: nga kurreshtja për t'ua parë, pas së gjithash, edhe bythët, edhe gjenitalet, njerëzve të kësaj familjeje!

Por, si asnjë herë tjetër, jam zënë tepër keq në rrjetën time! Pasioni po të shtyka në vdekje! Po vdes! Po vdes! Ka ditë të tëra që rri këtu, e terem e thahem për së gjalli. Kam shumë etje, kam shumë uri, dhe jam në pamundësi absolute për t'u çliruar nga kjo rrjetë e mallkuar. Nuk kam kufarë gjase për të mbijetuar. Madje, nuk kam kurfarë gjase, të zbres e ta ha, as atë copkën e vogël të mutit të tharë të këtyre njerëzve, që, se si paska mbetur pa u larë nga dyshemeja, prej sa ditësh.

Copëza e mutit të tharë, po m'i çon ligat, për atë zot!

MONOLOGU I FLAMURIT MBI VARRIN E DËSHMORIT QË RA PËR FLAMUR

Qëndroj në këtë bythë kodre, mes varresh. Ka vite që më kanë ngulur mbi kryet e varrit të këtij dëshmori, që ra për mua.

Jeta mes varresh është një tmerr i rrallë. Qetësia, e padrueshme. Era që m'i rreh pandalur trup e krahë, poashtu e padurueshme. Dielli përcëllues, i padurueshëm, poashtu. Digjem në diell e përcëllohem në erë, ditë për ditë, përgjatë shumë vitesh, gjithë verës. Dimrash, lagem e ngricem.

Dita kur më ngulën mbi këtë varr dëshmori, qe dita e varrimit të tij. Ishte një ditë korriku, e nxehtë, e nxehtë. Dielli vërtet përcëllonte mu si sot, por njerëz kishte shumë. Me mijëra e mijëra, besoj. Ajo qe dita e kulmit të përkrenimit tim.

Por, diagrami i jetës sime dhe i përkrenimit tim, është drejtëzë që bie. Ata që e njohin gramatikën e dhembjes dhe vetmisë, e dijnë se ç'dua të them.

Javën e parë mbi këtë varr, e kalova disi. Vinin ca më shumë njerëz, dhe nuk e ndjeja aq fort vetminë. LAVDI!-të që shqiptoheshin nga gojët e njerëzve mbi këtë varr, më jepnin përkrenim. Tek-tuk, merrja kurrajo edhe nga ndonjë fytyrë e përlotur. Lotët e familjarëve, nuk do t'i harroj, edhe kur të mos jem më. Lotët e asaj nëne plakë dhe lotët e asaj zonje të re, sidomos.

Por, për çudinë time, njerëzit shpejt rralluan! Për ditë e më pak njerëz vinin mbi këtë varr. Dhe, si rrallonin vizitat e njerëzve, ashtu shtohej vetmia ime, për aq sa, një ditë e kuptova se përkrenimi im dhe jeta ime qenkëshin të varura nga lotët.

Në javët që pasuan, nuk erdhi kush, përveç asaj nëne shamizezë, dhe asaj zonje të re, poashtu shamizezë, që filloi të vinte gjithnjë e më rrallë, me dy fëmijë përdore.

Si u bënë gjashtë muaj, e si nisi dimri e acarri, sytë e mi s'e panë më as zonjën e re me fëmijët. Veç zonja plakë vinte të premteve, aty kah mesdita, e derdhte lotë me grushte. Nuk më del mendsh figura e saj e zezë, tek ngjitej e kërrusur drejt varrit, mbi borën e bardhë.

Siç e thashë, vetmia ime shtohej. Dimri bëhej edhe më i egër. Era më rrehte, krah e m'krah. Përkrenimi im binte ditë për ditë, sipas diagramit të drejtëzës që bie.

Një të premte shkurti, s'u duk as zonja plakë! Me vete thashë: "Ç'ndodhi, o Zot? Oooo, vetmi, vetmi! Ooooo, dimërjetë!..."

Pas dy javësh, një të shtune që dhunohej misheshpirt nga dimri i egër, pashë katër figura të zeza njerëzish, që ecnin drejt varresh. Mbanin, mbi krahët, trupin e një kufome. Kur hynë në varreza, e u afruan tek unë dhe te varri i këtij dëshmori të ngratë, e mora vesh se e kishin sjellur ta varrosnin zonjën plakë.

Ah, do të harroja!

Pas një viti, në këtë rrugën që kalon këtu përposhtë varrezave, më ndodhi ta shoh duke kaluar zonjën e re. Nuk ishte me të zeza. I ngjitej një burri për krahu, me shumë dashuri. U kujdesa ta përkujtoj, me ca valëvitje dëshpëruese në erë, por ajo as kokën nuk e ktheu nga varrezat!

Tashmë, kanë kaluar vite, e s'shoh njeri të na kujtojë. Trupi im kalbet. Fytyra ime zbehet. Nuk jam më, as i kuq, as i zi. Po ndodhi të ju sjellë rruga këtej, do shihni se jam veç një leckë në erë. Leckosja dhe rrahjeera, paskan qenë fati im.

MONOLOGU I DIELLIT ME SY ZJARRI NË NJË AKT PERËNDIMI

Sytë e mi janë prej zjarri. Por, dita qe kaq. Kaq qe dëfrimi im me ju. Për sot, kaq. Mjafton, besoj.

Po ndahem i kënaqur nga ju. Mendoj se u kënaqa. Besoj se u kënaqët edhe ju. Ju kam ngrohur, ju kam dritësuar, e ju kam avulluar, si rrallë herë. Misioni im i vetëm është dritësimi, ngrohja dhe avullimi. Shkrihem në ndjenja, kur lëshohem e bij mbi tokë, mbi oqeane, e mbi detëra. Në ditët e mia, i dritësoj, i ngroh, e i avlloj, një për një, edhe liqejt, edhe lumenjtë, edhe përrockat, edhe gjallesat, edhe bimësinë.

Kur bie ora e perëndimit, e mbështes mjekrën time mbi këtë kreshtë mali, dhe mendoj për avullimin e ndjenjave. Pavarësisht, unë mendoj se ndjenjat e njerëzve dhe ndjenjat e luleve, janë me tharm prej uji, ndaj dhe avullojnë e bëhen re, njësoj si uji. Që këtej mendoj se vjen edhe dallimi në llojësinë e reve, në këtë qiell të madh e të mëshirshëm, ku lodrojmë gjithësisht.

Qielli, ku lodrojmë gjithësisht, është i madh. Aty ka vend edhe për re uji, edhe për re ndjenjash.

Me mjekrën mbështetur mbi këtë kreshtë mali, duket sikur po perëndoj, por sytë e mi të zjarrtë nuk perëndojnë kurrë. Ndjenjat e mia nuk janë me tharm uji. Me tharm zjarri janë. Nuk avullojnë, nuk bëhen re, nuk fiken...

Nejse, po e lë me kaq se s'më del kohë. Po iki, ta ngroh e dritësoj, fytyrën e dashur të Hënës. Ç'prej se ekziston bota, jam i dashuruar në të.

MONOLOGU I TAKETUKES NË KAFENENË E VOCKËL TË QYTEZËS N.

Gjë për gjëje s'dija, para se të më sillnin këtu. Këtu, ç'nuk kanë parë sytë e mi! Ç'nuk ka përjetuar, lëkura ime! Këtu, jeta ime u bë përdjegje. Këtu, jeta ime u bë edhe fikje!

Pikturë nga Shazim Mehmeti

Besoj, e kuptoni, se jam në këtë kafene të vogël të qytezës N.

Drita që njoha këtu është ndryshe. Dhe terri, është ndryshe këtu.

Nga mëngjesi deri në mesnatë, faqja ime zjarrin e përdjegjes duron. Pas mesnate, misterin e territ e të heshtjes, duron kjo faqe.

E këtillë siç jam, e ndjeshme, e qelqtë dhe e lëmuar, duroj. Duroj e shoh në fytyra njerëzish, në fytyra meshkujsh e në fytyra femrash. Kam parë të shfryhen shumë psherrëtima, prej gojësh të llojllojshme. Kam parë lloj lloj buzëqeshjesh. Kam vërejtur edhe këtë gjë: psherrëtimat janë të pak llojeve, ndërkohë që buzëqeshjet janë të llojeve të shumta. Ka buzëqeshje të çiltërta, që më ngjajnë me çastin e shpërthimit lulor të një pipthi. Ka buzëqeshje të lëmashkëta, disi të varura, të mezorrshme e të mezibëshme, që më ngjajnë me vyshkjen lulore.

Më kanë prekur, lloj lloj gishtash e lloj lloj duarsh. Gishta të lyer, dhe gishta të zverdhur prej cigaresh. Duar të buta, dhe duar të lodhura, me plasaritje të thella.

Kam parë lloj lloj sysh. Kam parë sy të ngërdheshur, sy të boshatisur, dhe sy të lodhur. Kam parë sy të shndritshëm, të gëzuar. Kam parë dhe sy të kuq, të frikshëm, që tmerrin ta shtyjnë më bark.

Po. Kam parë dhe barqe të llojllojshëm, por më shumë kam parë barqe të pangishëm.

Ç'nuk më kanë zënë veshët, në këtë tavolinë. Më kanë zënë biseda të ëmbla dashurie, dhe fjalë të zjarrta, që të bëjnë të mpakesh, nga ndjenjat që të zgjojnë. Më kanë zënë fjalë të gënjeshtërta, fjalë hipokrizie, të ftohta akull, dhe fjalë hidhërimi. Më kanë zënë veshët, edhe fjalë kërcënimi, fjalë goditëse dhe fjalë vrasëse.

Më ka ndodhur ta shijoj, edhe çastin e një vrasjeje, që ndodhi këtu përballë meje. Kam parë, me atë rast, në fytyrën e vrasësit, edhe mllefin vrasës, dhe vetëm një çast më pas, po në atë fytyrë, kam parë edhe pendimin, e i kam bërë vetes këtë pyetje: "Është apo s'është e njëjta fytyrë?..."

Nga ku jam, e nga ç'kam parë e ç'kam provuar mbi këtë faqe të përdjegur, më vjen t'i lëshoj këto psherrëtima: jeta është njëkohësisht, lule dhe gjak, buzëqeshje dhe psherrëtimë, etje dhe fresk, ngopje dhe uri, urrejtje dhe dashuri, vrasje dhe pendim, ikje dhe kthim, frikë dhe guxim, mërdhifje dhe zjarrmim...

Eeeeeee, asgjë nuk ju thashë, prapë se prapë, e as koha nuk më lë.

Është mesnatë, dhe po afrohen çastet e lumturimit tim. Ja, tek po vjen, e ëmbla, kamarierja. Vetëm edhe ca sekonda, dhe unë do jem në duart e saj. Vetëm edhe ca minuta, dhe faqja ime e përdjegur, do përjetojë freskun e ujit dhe freskun e fërkimit të duarve të saj. E dua atë fresk. E dua atë butësi duarsh. E dua atë lëmim. E di se çdo jetë ka një fund të vetin. Ndaj, lutem që fundi im të jetë, pikërisht në atë çast fresku uji e duarsh.

Ah, sikur të bij e të thehem, nga dorë e saj.

IMPERUM

cikël poetik nga

Fehmi Ajvazi

ESTETIKA BLU

Jeta virtuale kthehet në fakt
Me klithma e me shantazh

Riciklohet kënga e mortit
Nga skema të liga-hazarde
Thellësive të kriminalizuara
Kohërave të verdha

Librat i mbulon pluhuri modern
Pikturat e shenjta kidnapohen
Nga kont të zi e bajlozë
Që na e bëjnë ligjin mbi jetën

Ti se di çka ndodh tutje hundës
As pse dialektika është e zezë
Jeta virtuale blihet me një lek

Plogështia e mëngjesit na plakë
Estetika blu na mbulon me lym
Lakuriq dëftohet shpirti ynë
Pak nga pak mbërthyer në kryq
Në zjarr lind e vdesë fati njerëzorë

JUSTINIANI PARA PASYRËS

Senati vendosë për luftë të fundme
Egalite-ja jep shpirtë
Te këmbët e legjionit të 19-të

Perandorinë s'ka kush ta shpëtojë
Në vigjilje të fillimit të fundit tragjik

Gjakun se lanë shiu as bora
Rrugëve të pista të imperumit
Laviret e sundojnë historinë

E qarë kupola e një renesance plotë lavdi
E mbërthyer në kryq fryma e shpirtit

Të harruar janë bijtë e Eneut
Të mbyllura janë portat e perandorisë

Copë e grimë bëhen pasqyrat në imperum
Senati abdikon flamujt digjen n'zjarr
Një qytetërim i kalbur përfundon në llum

SAN SIRO

Aty shkojnë bashkë
Të varfër e të braktisur
Aristokrat e vrasës
Mashtrues e gjeni
Të klithin një çast
Të bëhen një

Edhe kur dielli ngroh
Edhe kur frynë e bie shi
San Siro të gjithë
I bënë një...

Rrëke vjen ëndërrimi
Klithma e dëshpërimi
Nga jehet nga heshtja

Aty në rrafshin sfidues
E njohim fitoren-humbjen
Tek e kuptojmë esëll
Emblemën njerëzore

Në San Siro tej n'fund
Klithma epike
Dëshpërimin e mund

LETËR NGA ANA FRANKU

E dashur: librin tënd e kam lexuar
Gjysmë shekulli më vonë
Mes dritës së mekur të robërisë

Aty isha dhe unë - diku afër teje
Duke i dëgjuar lutjet t'ua
Duke e mashtruar vdekjen

A mashtrohet vdekja e dashur...?

Prandaj isha në ferr dhe unë
Kisha frikë si t'i - kisha dhimbje si t'i

Anë : ende kam shumë drojë
Dhimbja nuk na ka braktisur
Liria përgjaket e kryqëzohet shpesh
Sa herë vjen mes nesh
Mbretëria e të marrëve...

SHI NË KARTAGJENË

Sa herë vijnë përvjetorët
Unë kapërcej bregun e yjeve
Lule ëndrrash shkoj të mbledh
Në tregun e tiranëve të zi

Përvjetorët janë të ndryshëm
Të bardhë të kuq kaltër zi...
Lule ëndrrat ua dërgoj atyre
Të dashurve të m'i

Ua lë te këmbët e gjymtuara
Te zemrat e përvëluara
Tufat e lirikave me shi

Shi në Kartagjenë sërish
Mijëra vjet më vonë...

XHIM MORISONI

Kur dhimbja shndërrohet në uragan
Lind një yll që peshon rënd
Sa dita e fundit n'këtë botë

Kur kënga kthehet në protestë
Oqeanet mbyten nga lotët njerëzorë

S'ka gjë më e keqe se dhimbja Xhim
Ti që vdiqe për një pikë mendimi
Në universin plotë me pikëllima

Xhim jeton ende me ne
Me ato ritme plotë zjarr
Me ato vargje homerike
Hero i klithmave...

NJERIU I MARRË

tregim nga

Biser Mehmeti

Në shtëpi tash e disa ditë çdo gjë më ngjallte monotoni, e cila shkallëzohej në apati. Dola jashtë sikur djalli të më godaste me grushta në kokë. Disa çaste u sorollata nëpër rrugë kuturu pa ditur ku isha nisur të shkoja as çka kërkoja. Kur këmbët filluan të më këputën në gjunjë u ndala. Disa çaste e vështrova hapësirën ku gjendesha. Pak më larg e pashë parkun e vetëm të qytetit. Me hapa të rëndë mezi arrita deri aty. Në një ulëse e pashë një njeri me moshë mesatare. Sapo u ula afër tij ai zuri të turfullonte si një kalë i harbuar. Tri herë pështyu drejt meje e pastaj u ngrit i mllefosur dhe u largua nga unë. Sjelljes së tij nuk i kushtova vëmendje... Kisha dëshirë të qëndroja aty një kohë të gjatë duke i vështruar kalimtarët si sorollateshin rrugëve. Disa prej tyre sapo më shihnin zgërdhiheshin me mua, kurse unë nuk e kuptoja pse e bënin një gjë të këtillë...

Kur u lodha duke e vështruar vjeshtën që sorollatej si një kalë i harbuar m'u kujtua se me vete kisha marrë një roman sentimental, të cilën fillova ta lexoj i shpërqëndruar. Nga humnera e leximit më kanë trandur disa zëra të çakorduar, të cilët sikur jehonin nga një skaj i qiellit. Me sytë e vagëlluar i pashë tre djem e dy vajza si qëndronin afër meje, të cilët më shikonin me një vështrim zhbirues. Ndoshta kishte një kohë të gjatë që qëndronin afër meje, po s'e kisha hetuar prezencën e tyre. I vështrova me një indiferencë të çuditshëm. Në mendjen time ata u shëmbëllenin disa personazheve të shëmtuara që i kisha lexuar në një roman nga i cili isha tmerruar... Njëri prej tyre zuri të pështynte me neveri drejt meje. Ndoshta dëshironte të më pështynte në fytyrë, po s'kishte guxim. Një tjetër zuri të zgërdhihet sikur një shpirt i keq ta kishte pushtuar trupin e tij... Pthu, ç'njerëz të marrë, thashë me vetvete... Nuk më lënë të rri i qetë në parkun e qytetit!... Derisa i vështroja me radhë njëri prej tyre zuri t'i nxjerrte nga goja do fjalë me një eufori të shrenuar: hi-hi, ky njeriu i marrë sërish paskëshka dalë në park për të lexuar!... Një vajzë tjetër, me flokë të shkapërderdhura, tha me zë të çakorduar: ka tri javë që ky i marrë prej mëngjesit deri në mbrëmje qëndron në park dhe e lexon të njejtin roman!... Një tjetër klithi me zë të çjerrë: ky njeri i marrë vetëm shtiret se lexon, sepse nuk di të lexojë!... Prita edhe një tjetër të fliste gjëra të neveritshme, po ai e fryu një çamçakëz afër fytyrës sime e pastaj lëshoi do qeshje sardonike... Një mendje më tha: ngrihu nga vendi e theju brinjët këtyre idiotave që të shqetësojnë pa arsye!... Sapo dasha ta bëj një gjë të këtillë një zë brenda meje më tha: mos u tërbo nga fjalët e njerëzve të marrë!... Vendosa ta ruaj gjakftohtësinë, edhe pse e kisha të vështirë. Vazhdova të qëndroj indiferent ndaj fjalëve të tyre... Një tjetër, të cilin nuk kisha dëshirë ta shihja, klithi me zë të lartë: o njeri i marrë, ma jep atë libër se ty nuk të duhet!... Pastaj deshi të ma rrëmbej librin me dhunë. Unë nuk e lëshova librin nga duart... Njëri zuri të më godaste fytyrës me shpullë. Në atë çast u afrua një njeri i moshuar, i cili ia largoi dorën nga fytyra ime... Nuk është në rregull ta shqetësoni njeriun e marrë, u tha atyre me zë të qetë. Të gjithë më vështruan me përbuzje. Duke ulëruar si ujq të uritur u larguan nga unë... Me sytë e vagëlluar i vështrova si u tretën në hapësirë sikur të ishin hije të natës që gabimisht shfaqën ditën. Edhe pasi ata u zhdukën si një ankth i mundimshëm nëpër mendje vazhdonin të më sorollateshin fjalët e tyre, të cilat më godasnin si me çekan. Mornica të ftohta ma përshkuan trupin. Pse më quajtën "të marrë!", e pyta vetveten. Një zë i brendshëm më tha: unë jam i marrë, ndryshe ata s'do të më shqetësonin me fjalë banale!... Për ta larguar mendjen nga ata njerëz të pasjellshëm u mundova të vazhdoj të lexoj, po nuk arrija të përqëndrohesha. Me sytë e vagëlluar zura t'i vështroj njerëzit që sorollateshin rrugëve pa ndonjë qëllim të caktuar. Disa prej tyre sikur më vështronin vengër me një urrejtje të paqartë. Sapo më shihnin pështpërisnin në mes veti me zë të çjerrë: a e sheh atë njeri të marrë si qëndron me libër në dorë e nuk lexon asgjë!...

Në një çast që erdhi më vonë e pashë veten se dridhesha, po nuk e dija nëse dridhesha nga ethet e ftohta apo nga ethet e frikës. Më kishte kapluar dyshime se njerëzit që sorollateshin nëpër park do të më gjuanin me gur e pastaj do të klithnin: nuk duam ta shohim këtë njeri të marrë si qëndron në park tërë kohën!... Kisha frikë se do të përjetoja një vdekje të neveritshëm... Një zë që nuk e di nga jehonte më tha: pse nuk shkon në shtëpi të çlodhesh nga fyerjet e njerëzve, të cilët veten e konsiderojnë të mençur!... Përsëri desha të ngrihem nga vendi e të shkoja në shtëpi. Një mendje më tha: ti nuk je i marrë, ata që të fyejnë ty janë të marrë! Për inat të tyre mos u largo nga parku, qëndro këtu derisa të lëshohet errësira e mbrëmjes!... Derisa qëndroja i shtangur si një statujë prej balte herë pas here i vështroja njerëzit, të cilët ecnin me hapa të ngadalshëm. Disa prej tyre më vështronin vengër dhe derisa e bënin një gjë të këtillë lëshonin qeshje të gjata sardonike. Me zë të çjerrë thoshin: sa herë e shoh këtë njeri të marrë mendtë më merret e zorrët nëpër bark më përzihen!... Derisa me sytë e vagëlluar i vështroja gjethet e zverdhura si binin në tokë nga era, një mendje më tha: ndoshta më mirë është të jesh i marrë sesa i mençur!... Ndoshta më të lumtur janë njerëzit e marrë se njerëzit e mençur! Përsëri një zë i brendshëm më tha: mos qëndro në këtë vend, ngase kalimtarët të fyejnë me fjalë banale! Sa më shumë që të fyejnë, ti e ndjen veten sikur je i marrë! Shko në shtëpi e qetësoje shpirtin e trazuar... U ngrita nga vendi edhe pse nuk dëshiroja të largohesha. Dëshiroja edhe më tutje të qëndroja aty pa e ditur çka kërkoja. Përsëri u ula e pastaj fillova ta lexoj romanin "Iluzionet e humbura"... Në një çast hetova se para meje u shfaqen tre ose më shumë njerëz. Kur i vështrova ata u shëmbëllenin do hijeve që janë ngritur nga varri. Njëri prej tyre u mundua të ma rrëmbente romanin... Të marrëve nuk u duhen librat, më tha me zë të mllefosur. Vazhdova ta shtërngoj librin me sa fuqi që kisha... Ma parë ta jap jetën se ta jap librin, i thashë me zë të mllefosur. Kur u bind se nuk mund të ma merrte librin më pështy dy herë në fytyrë. Atëherë u ngrita nga vendi e pastaj klitha me sa zë që kisha: unë nuk jam i marrë! Ju jeni të marrë!... Më leni të qetë!... Vetëm atëherë pashë se rreth meje ishte grumbulluar një turmë e madhe e njerëzve të cilët më vështronin me habi të madhe. Disa lëshonin klithma e ovacione. Disa qeshnin e talleshin me mua. Tre ose më shumë u afruan te unë. Me duar filluan të m'i copëtojnë rrobat e trupit. Më kot u orvata të mbrohem prej tyre. Turma vazhdimisht klithte me zë të shfrenuar... Duke i mbajtur me dorë pjesët e trupit që më bënin të ndihesha i turpëruar ngadalë desha të largohem prej aty. Njëri nga turma më goditi me grusht në kokë. Më duket sikur nga aty zuri të më rrjedh gjaku rrëke. Si një ujk i tërbuar jam vërsulur drejt tij. Me duart që më dridheshin e kam rrëmbyer për fyti. Ai zuri të nxjerrte shkumë të bardhë nga goja... Unë nuk jam i marrë, klitha me sa zë që kisha... Desha të klithi edhe më tutje, po përsëri dikush më goditi me një send të fortë në zverk. Më ngjau sikur ma këputi kokën nga trupi. Me sytë e vagëlluar e kam vështruar turmën e shfrenuar, e cila vazhdonte të tallej me mua. Jam munduar ta ruaj drejtpeshimin e trupit, po s'kam arritur. U plandosa në tokë si i vdekur. Turma vazhndoi të klithte e të çirrej me zë të shfrenuar: mbyteni njeriun e marrë!... Shtatë ose më shumë njerëz u afruan te unë e pastaj filluan të më godasin me grushta e shqelma... Pas pak filluan të më tërhjekin zvarrë nëpër rrugë. Nuk e kisha të qartë ku po më shpinin. Ndoshta më shpinin te varret... Me sytë të vagëlluar e kërkoja librin, të cilin nuk e di ku e kisha humbur...

REVISTA LETRARE DHE MISIONI I SAJ PREJ "PLACENTE"

Eseja si pjesë rëndësishme e revistës letrare

nga Mira Meksi

Shpesh bëhet pyetja: për se shërbejnë në thelb revistat letrare dhe ç'rëndësi apo çfarë misioni kanë, kur në të vërtetë produkti i letërsisë apo kulmimi i saj është libri? Një nga përgjigjet më të sakta kësaj pyetjeje ia ka dhënë filozofi dhe shkrimtari spanjoll Jose Ortega y Gasset, i cili thotë: "Edhe duke qenë më i përsosuri, libri është përherë një abstragim, një fragment. Gjysma e tij mbetet në placentën e nënës, ku u ushqye, në ambientin e fshehtë të ideve, të parapëlqimeve, postulateve, të dhënave që ishin atmosfera e mbirjes së tij si filiz. Si çdo gjë thelbësore, letërsia vuan nga një kontradiktë e pamëshirshme. Sepse nuk ka pikë dyshimi që letërsia finalizohet me librin; me të ajo kulmohet, me të frytëzohet, dhe nga ai merr emrin. Porse, nga ana tjetër, libri është vetëm një çast i fluksit intelektual, që tek ai ndalet, kristalizohet dhe ngrin. Në çdo libër ka diçka të rreme në lidhje me jetën intelektuale efektive, një rremtësi e ngjashme me atë që ndodh me lëvizjen në fotografinë e çastit. Për të korrigjuar pak a shumë këtë defekt të lindur të librit duhet të shërbejë revista, ajo ka një mision të ngjashëm me atë të placentës. Revista duhet të dallohet nga libri njëlloj siç dallohet publikja nga privatja." Pra, libri është vepra e kthyer në send, në diçka të ngurtësuar, ndërkohë që jeta intelektuale rrjedh dhe vepron para dhe pas tij, por ajo shfaqet edhe në forma përgatitore, ku ka gjykime, dyshime, kureshti etj. Do të qe shumë interesante që në një revistë shkrimtarët të botonin ato që nuk shkojnë kurrë nëpër libra, gjërat e parakohshme, të palindura, të fshehura; madje edhe kur botojnë vepra në proces, pjesëza të asaj krijimtarie që më tej do të shkojë të ndryhet e të "ngrijë" në libër, sërish ajo formë e parë e saj flet për një tjetër klimë të fshehtë dhe parake të krijimit. "Na pëlqen libri kur është bërë mjaltë, por njëlloj do të na pëlqente të ishim të pranishëm gjatë procesit të mjaltëzimit, të shihnim drithërimën e bletëve në korsetë e tyre të arta", - thotë Jose Ortega y Gasset.

Dimensionin e fenomenit letrar vetëm revista mund ta paraqesë. Nga libri në libër nuk i vëmë dot re as devijimet, as eksperimentet që bën shkrimtari, gjersa magma e tij ngrin brenda dy kapakëve. Në revistë po, e që këtej roli i saj i domosdoshëm në zhvillimet e letrave. Ndërsa shtypi letrar (më e shumta faqet e të përditshmeve kushtuar kulturës dhe letërsisë), shumë i rëndësishëm edhe ky, ndryshe nga libri dhe revista letrare, që janë letërsi në ngjizje e sipër, duhet ta shohë letërsinë për së jashtmi, si një fakt dhe të na informojë mbi luhatjet dhe ndryshimet e saj, të na përshkruajë gëlimin e ideve, të veprave, të emrave krijues, të na japë, me aq sa mundet, një lloj hierarkie letrare, përherë të ndryshueshme, por që, sidoqoftë, përherë ekziston. Por çfarë specifikash kanë revistat letrare, këto "korrigjuese të defekteve të librit"? Ato mund të klasifikohen në dy grupe: revista të krijimit letrar të një toni polemik; dhe revista erudicioni, investigimi dhe kritike. Të dyja grupet kanë një rëndësi të caktuar për zhvillimet letrare, por për nga karakteri tepër i përkohshëm dhe dalja në momente tronditjeje, gumëzhimi apo shqetësimi letrar paraqesin më tepër interes dokumentar ato të grupit të parë. Në këtë kuptimin e fundit është folur, siç u tha më sipër, për misionin e tyre si një mision prej placente (njëlloj si placenta, që bashkon trupin e fëmijës me të nënës në barkun e saj), pasi ato në përgjithësi mbledhin materiale letrare që më të shumtën e herës nuk arrijnë të ngjizen në një libër. Thuhet se revistat letrare lindin me një lloj zelli ikonoklast, pasi për të çarë udhën, për të imponuar kredon e tyre estetike besojnë se hapi i parë që duhet të bëjnë për këtë është të shkatërrojnë kredon paraardhëse. Plot shembuj të tillë ka me revistat tona që lindën fillimviteve '90 dhe që nuk patën jetë të gjatë, por që në njëfarë mënyre e kryen misionin e tyre prej krijimtarie polemike. Në përgjithësi lëvizjet apo rrymat letrare shfaqjen e tyre të parë e kanë pasur nëpër revistat letrare, madje flitet se asnjë periudhë apo shkrimtar që nuk është shfaqur më parë nëpër revista letrare, me përjashtime të rralla, nuk meriton vëmendje. Revista letrare paraprin, parashikon, zbulon dhe polemizon, madje përgatit përkthyesit dhe shkrimtarët e së nesërmes. Revista letrare "Mehr Licht" u krijua në vitin 1996, në një kohë kur kishin lindur të paktën tri prej shtëpive botuese private (që sot janë kryesoret në treg), të cilat përpiqeshin me ç'mundnin të kënaqnin grykësinë e lexuesit shqiptar për veprat e ndaluara gjatë 50 vjetve, të kapnin kohën e humbur, ta mbushnin atë boshllëk dhe të pasqyronin njëkohësisht aktualitetin e letrave botërore. Ndërkohë risitë që krijoheshin në letrat shqipe brenda lirisë së rigjetur nuk qenë fort tërheqëse për këto ente botuese; vazhdonte të mbetej në hije letërsia e ndaluar shqipe dhe po ashtu në harresë edhe një pjesë e mirë e letërsisë sonë të traditës, ndërsa letërsia e krijuar brenda mureve të burgjeve mbetej gjithashtu e pazbuluar, edhe kjo jo shumë e kërkuar nga botimet private. Në këtë vrap të çmendur në kërkim të kohës së humbur botimet e shtëpive botuese private në më të shumtën e rasteve (pa dyshim që ka edhe përjashtime) nuk ndiqnin kurrfarë rregulli apo protokolli në lidhje me përkthimin letrar. Rezultati qe shkatërrimtar për letërsinë në përgjithësi: pati një çoroditje në vlerësimin e mirëfilltë letrar, që u shoqërua me një mungesë të theksuar të një reference a të një sistemi vlerash. E pra, gjatë 14 vjetve të jetës së saj si shërbesëtare e letërsisë dhe kulturës kombëtare, revista letrare "Mehr Licht" ia ka dalë të promovojë shkrimtarë dhe përkthyes letrarë shqiptarë; ajo është kthyer jo vetëm në një enciklopedi të letrave botërore dhe shqiptare, me një formacion të tejbollshëm për to dhe "vendshfaqjeje" për të gjithë produktin letrar jo fort të përfillur nga tregu i botimit privat, që u përmend më sipër, por edhe për krijimet, idetë dhe eksperimentimet letrare të krijuesve të rinj dhe jo të tillë shqiptarë. Ajo është munduar të nxisë, veç të tjerash, zhvillimin e gjinive letrare pak të lëvruara te ne aktualisht, siç janë eseja letrare dhe kritika letrare, të cilat përbëjnë një lëndë të rëndësishme të revistave letrare. Këtë e ka bërë nëpërmjet rubrikave të saj të përhershme, siç janë rubrikat "Ese" dhe "Studime". Tani "Mehr Licht" po rikthen traditën e saj të dhënies së çmimit për esenë dhe kritikën letrare, që do të jetë i përvitshëm dhe do të jepet nëpërmjet një konkursi. Produktet më të mira të këtyre gjinive gjatë një viti do të botohen në suplementin e revistës në numrin e fundvitit. Një nga qëllimet e këtij shkrimi është të ndalet edhe te kritika letrare dhe eseja, të cilat janë gjini letrare që pasurojnë, porse, siç u shprehëm më lart, pak të lëvruara aktualisht te ne. E kemi bërë zakon të flasim, të gjykojmë dhe të japim mendimin tonë për letërsinë, një vepër letrare apo problemet që lidhen me letërsinë dhe kulturën në përgjithësi kafeneve, por pak e bëjmë këtë publikisht; shpesh kritika letrare ngatërrohet me opinionin e keq mbi një vepër, apo, përkundrazi, me thurje lavdesh për të. Me pak fjalë, kritika letrare është arti i të gjykuarit të një produkti letrar, i veprave letrare, është studimi, vlerësimi dhe interpretimi i letërsisë. Ky gjykim mund të prekë shumë faqe të këtij produkti, që nga shqyrtimi i faktit se si është ngjizur vepra letrare dhe në ç'masë ajo i pëlqen lexuesit, që nga vrojtimi i shpikjeve apo risive që ajo përmban e gjer te gjykimi mbi stilin, korrektësinë gramatikore, figurat letrare etj. Kritika letrare mund të ketë formën e një studimi teorik apo të një prezantimi dhe përmbledhjeje, e cila merr formën e një shkrimi gazetaresk. Ky i fundit është edhe më i *frytshmi* apo më

Leximi i ndaluar dhe shkrimet e fshehura

Mira Meksi

orientuesi për masën e lexuesit, që shpesh gjendet i çorientuar për sa i përket zgjedhjes së një vepre letrare për të lexuar. Që këtej edhe roli apo misioni i kritikës letrare, jo vetëm si udhërrëfyese vlerash, por ndoshta edhe si edukuese shijesh letrare. Sa për esenë, ajo është një letërsi idesh. Ndonëse ka moshë të lashtë, sërish mund të thuhet se është një gjini moderne. Një nga tiparet e saj të thelbëta është zhdërvjelltësia, që do të thotë se ka një thjeshtësi shprehjeje dhe një aftësi për të komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e, mbi të gjitha, në përgjithësi për tema të aktualitetit. Gjuha e saj është direkte, por elegante; nuk ka detaje dhe hollësira të sipërfaqshme dhe forma e saj është e thjeshtë, por përmbajtja ka një informacion të saktë. Eseja ngre një sërë pyetjesh dhe jep përgjigjet që mundet, por pothuaj asnjëherë nuk arrin dot të japë të gjitha përgjigjet, pyetja mbetet. Me gjithë vështirësitë për t'u përcaktuar, sërish mund të thuhet se, sidoqoftë, eseja duket të jetë e kundërta e një mendimi që ka mbërritur në fazën e tij përfundimtare, pasi ajo është trajtimi i një apo më shumë subjekteve, por pa i shteruar ato. Eseja është, si të thuash, një vepër që paraqet gjendjen aktuale të mendimit. Eseisti propozon një diskutim idesh, për të qenë më të saktë, ai propozon një lloj intuite të menduar e të peshuar mirë. Tjetër karakteristikë të saj eseja ka faktin që e trajton subjektin në shumë pikëpamje, duke hapur një maksimum këndesh goditjeje dhe përdor shumë citime. Eseja është fusha e mendimit të lirë dhe fushëgjerë; këtu qëndron edhe dallimi i saj me gazetarinë, pasi kjo e fundit propozon një pamje të vetme dhe të përqendruar.

Në kapitullin 50 të librit të parë, që e titulloi "Nga Demokriti dhe Herakliti", Montaigne-i, mjeshtri i esesë dhe ai që i dha emrin qysh në mesjetë, na jep një përcaktim të esesë, që ka vlerë edhe sot e kësaj dite, përveç vlerës historike, sigurisht: "Gjykimi është instrumenti i nevojshëm në ekzaminimin e çdo lloj gjëje, andaj edhe unë e përdor në çdo rast në këto *sprova*. Kur bëhet fjalë për një lëndë që nuk e kuptoj, me plot arsye e përdor gjykimin, duke e hetuar thellësinë e lumit për të gjetur vaun, dhe pastaj, nëse më ngjan fort i thellë për trupin tim, mbaj këmbët në breg të tij. Bindja për të mos shkuar më tej është një shenjë e vlerës së gjykimit, dhe nga ato që kanë rëndësi të madhe. Shpesh rrekem që një objekti pa peshë dhe hiçmosgjë t'i jap rëndësi dhe ta konsolidoj; tjetër herë përsiatjet e mia i përkushtohen një çështjeje të fisme dhe fort të rrahur si diskutim, ku nuk gjen asgjë të re, pasi udha është shkelur aq shumë nga të tjerë njerëz, sa s'të mbetet veçse të ndjekësh gjurmët e paraardhësve. Në rastet e para gjykimi gjendet në ujërat e veta, zgjedh udhën që i do qejfi dhe mes mijëra shtigjeve përcakton atë që i përshtatet. Zgjedh kuturu argumentin e parë. Të gjithë për mua janë të mirë njëlloj dhe asnjëherë nuk i vë vetes qëllim që t'i shteroj gjer në fund, sepse asnjërin prej tyre nuk e rrok tërësisht: nuk thonë më shumë ata që na premtojnë t'i trajtojnë tërë aspektet e gjërave. Nga njëqind gjymtyrë dhe fytyra që ka çdo gjë, zgjedh njërën, herë për ta lëpirë, herë për ta përkitur, dhe herë për ta shpuar gjer në kockë. Përsiatem mbi gjërat jo duke u shpërndarë, por duke u thelluar aq sa kam mundësi dhe shpesh më pëlqen të studioj ndonjë xixëllim të tyre të pazakontë."

Është për t'u vënë në dukje fakti se sot esetë apo sprovat kanë një lexues shumë të gjerë dhe gëzojnë sukses në tregun e librit. Si mund të shpjegohet një gjë e tillë? Sipas kritikëve, por edhe sociologëve, ndonëse eseja nuk është përherë fort e lehtë për t'u kuptuar, ajo e tërheq lexuesin, sepse: së pari, ky i fundit është shumë i dhënë pas trajtimeve që kanë një nuancë autobiografike (shumë ese e përmbushin këtë kriter), pasi është mendimi, idetë dhe pikëpamjet e autorit që shprehen haptazi dhe pa dykuptimshmëri në të; dhe së dyti, lexuesi pret apo mëton të ketë përgjigje për probleme ekzistenciale dhe thelbësore, sidomos për ato aktuale, siç është rasti me sprovën e fundit të Kadaresë "Mosmarrëveshja". Kjo sprovë është mbase e para dhe e vetmja, pas një shekulli e ca, që për nga rëndësia dhe ndikimi barabitet me një nga veprat më të mëdha të Rilindjes, me manifestin e saj politik dhe ideologjik "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet" të S. Frashërit. Numri i jashtëzakonshëm i shitjeve, dhe në një kohë shumë të shkurtër, i kësaj sprove, e cila godet dhe intrigon që me titullin e saj: "Mbi raportet e Shqipërisë me vetveten", ka rrëfyer të paktën dy gjëra shumë të rëndësishme në lidhje me lexuesin shqiptar: *e para*, në këtë kohë që jetojmë, kur vazhdojmë të kemi probleme të pazgjidhura me të kaluarën dhe historinë tonë, kur afria konceptuale historimit përdoret *tinëzisht* për të rrëzuar shenjat e kombit në emër të modernizmit dhe të luftës kundër nacionalizmit të sëmurë, kur ekziston një gjendje e amullt dhe kaotike e mendimit shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti ndaj çështjeve ekzistenciale të aktualitetit, lexuesi shqiptar është në kërkim të pikave të sigurta të referencës për të pasur përgjigje për pyetjet thelbësore që lidhen me kombin, historinë dhe aktualitetin; *dhe e dyta*, lexuesi shqiptar është ngulmazi në kërkim të mjeshtërve të konsoliduar të mendimit të sotëm shqiptar. Mbase në këtë pikë vetë sprova apo eseja si gjini është e detyruar të përballet me një rrezik modern, rrezik që koha do ta tregojë nëse do ta ndryshojë thelbin e saj. Ajo po perceptohet vetëm si një tribunë e përgjigjeve, ndërkohë që në të vërtetë është vendi i ngritjes së pyetjeve.

11 dhjetor 2010

NJË PËRKTHIM MJAFT I TJETËRSUAR I BALADËS "DER ERLKÖNIG" TË J.W. GOETHE-s

nga Arb Elo

Im nip, që është tanimë gjimnazist e të cilit i duhet në shkollë të analizojë "Faust"-in e Gëtes, por edhe "Cubat" e Shilerit dhe "Fizikanët" e Dyrrenmatit, u bë shkas për radhët e mëposhtme.

Meqenëse mes nesh bie kësisoj shpesh fjala për Gëten, më është dashur mua vetë së pari të rifreskoja dijenitë e mia për këtë klasik jo vetëm të gjermanishtes e ta përjetoj nga afër kështu peshën që ai ka në mësimdhënien dhe edukimin letraro-gjuhësor në botën gjermanofolëse, ku më ka rënë fati edhe të jetoj.

Ndaj ishte afërmendsh të nisesha e të rikujtoja ca lexime të largëta të veprës së tij, të dhënë asokohe në shqip nga S. Luarasi, në më kujtohet mirë, si edhe të kërkoja të tjera shqipërime në rrjet, për të gjetur kështu emra nga më të njohurit, që janë marrë me Gëten. Fan Noli, Luarasi i lartpërmendur, Ndre Mjeda, Sejfulla Malëshova, Lasgush Poradeci, Perikli Jorgoni, Shpëtim Çuçka, etj.; radha e tyre lexohet si një "who is who" e ajkës së përkthimit shqiptar.

Nuk mund të mungonte aty edhe emri i Robert Shvarcit me një shqipërim të tij të një balade të Gëtes, me të cilën kanë edhe të bëjnë rreshtat që vijojnë: °Der Erlkönig". Titull të cilin Shvarci e ka dhënë me "Mbreti i pyllit".

Mu këtu, qysh në titull, nis edhe vështirësia e shqipërimit të kësaj vjershe fort popullore, që u jepet shpesh nxënësve të fillores këtu, kur këta nisin e merren me gjuhën dhe letërsinë e vendit të tyre, e të cilën shumë gjermanë e identifikojnë, - bashkë me "Faust"-in, natyrisht, - me emrin e rëndë të autorit.

Subjekti i këtij shkrimi është pikërisht firoja e nuancave të një teksti poetik nga një gjuhë në tjetrën, përgjatë shqipërimit të kësaj pjese, humbjes që i ndodh nga ndërskriptimi origjinalit - humbje për të cilën, kuptohet, nuk mund të bësh e as nuk po dua të bëj me faj kënd - aq më pak përkthyesin e njohur e të ndjerë R. Shvarc, i cili na ka dhuruar në shqip sa e sa shqipërime mjeshtërore.

E megjithatë, - për fat të mirë a të keq, vështirë të ftillohet kjo, - askush nuk është i imunizuar prej lajthitjeve, në qofshin këto më poshtë të tilla; as Shvarci, e admirimi që kam përjetuar kur kam lexuar »Tre shokë«, bie fjala, nuk më pengon ta lexoj çdo tekst të tij sikur të ishte i pari. Parantezë mbase e panevojshme kjo më sipër, por ja që ndjeshmëria jonë (po dua ta shmang fjalën: shqiptare) është shpesh fort më patetike se shija kritike kur bie fjala te figura të tilla si ky, por edhe Kadareja etj., ndonëse kjo është temë tjetër dhe, tekembramja, nuk është as e tillë, temë pra: të tjera halle ka ky popull, ndërsa këto më sipër janë luks, këto "halle" ku m'i gjen. Po dua të them se problemin unë e kam me tekstin e jo me përkthyesin e tij. Çka ndoshta mund të mëtohej në formë kritike këtu do të ishin të tjera përkthime, të cilat mbase do të nxirrnin anë të tjera të tekstit të Gëtes në pah, anë që kanë firuar në shqipërimin e Shvarcit, ndërkohë që për hijeshinë, metrikën dhe poezinë e këtij të fundit nuk më takon aspak mua të gjykoj; këtu më intereson vetëm saktësia gjuhësore dhe besnikëria ndaj origjinalit. Vështirësia, siç shkrova, nis qysh në titull. Erle në gjermanisht ka kuptimin e një verri (VERR *m. bot. Dru i ulët me lëvore të lëmuar ngjyrë hiri, me gjethe vezake e të dhëmbëzuara, dhe me lëndë të fortë që rritet buzë lumenjve e në vende me lagështirë dhe që përdoret zakonisht në ndërtim. Verri i bardhë. Verri i zi. Dru verri. Gjethe verri. Pyll me verra.*), mirëpo nuk është aspak e qartë nëse vetë Gëteja ka patur këtë parasysh, pemën pra, kur e ka shkruar baladën apo bëhet fjalë këtu për një gabim të transportuar po ashtu nga një përkthim tjetër nga danishtja, përkthim ky i Herderit i një balade me subjekt të ngjashëm, i cili e ka sjellë fjalën *Ellerkonge* kësisoj, si *Erlkönig* pra, por që do i binte të ishte *Elfenkönig* në gjermanisht, mbreti i zanave pra, i orëve, shtojzovalleve, karkanxhollëve, etj., varësisht si do të jepej në shqip fjala *Elf* e gjermanishtes.

Me një fjalë, nuk është e qartë nëse Gëteja e ka transportuar lapsusin e mundshëm të Herderit në baladën e tij; ndërkaq dihet me siguri se përkthimi i këtij të fundit i baladës daneze ka qenë materiali, prej nga Gëteja është nisur të shkruajë versionin e tij.

Më e ndërlikuar bëhet kjo e tëra kur gjen në fjalorin gjermanisht-shqip të Ali Dhrimos (kam përpara botimin e vitit 2007, Infbotues) fjalëformimin "Erlkönig" të dhënë në shqip me të barazvlershmin "mbret i pyllit" e ku është pothuajse e pamundur të zhbirilohet, nëse Shvarci e ka marrë titullin e tij prej këtej, apo Dhrimoja është mbështetur te Shvarci për ta futur fjalëformimin në fjalorin e tij në këtë formë.

Nuk dihet pra me saktësi nëse Gëteja donte të thoshte "Mbreti i verrishtes", apo "Mbreti i zanave"; ajo që unë kuptoj derimë këtu është që "Mbreti i pyllit", - në mos më tepër një farë kompromisi për të dalë nga

kjo dilemë, - është, pak të thuash, titull shumë i pasaktë e që e tjetërson shumë atë të Gëtes, që ka zënë vend vetiu edhe në gjermanisht si i tillë e të cilit shumëkush ia merr me mend semantikën, mbase edhe pa e ditur mirë se ç'është vërtet një „Erlkönig".

Kush kalëron kaq vonë nëpër natë dhe erë? - përkthimi literal i vargut të parë gjendet te Shvarci si: *Kush sulet me kalë nëpër terr e stuhi?*

Nata bëhet terr, era bëhet stuhi, kalërimi bëhet: sulet me kalë. "Es ist der Vater mit seinem Kind" - *Është babai me fëmijën e tij* -; Gëteja nuk e qartëson akoma gjininë e fëmijës këtu, - kreshendo e cila ndodh një varg më tutje: Er hat den Knaben wohl in dem Arm - *E mban çunakun mirë e bukur* - ose: *shëndoshë e mirë në krah.*

Te Shvarci *fëmija* bëhet *djalë* dhe kreshendoja ndodh në kah të kundërt, djalin e shohim në vargun e tretë tash si foshnjë, ndonëse është paksa e vështirë të përfytyrohet një foshnjë të trialogojë, siç do të ndodhë më poshtë, me babain dhe mbretin, në atë formë.

Mund të vazhdohej kështu deri në fund e të analizohej e tërë balada sikurse dhe përkthimi i saj, mirëpo kësisoj nuk do i bëja nder as përkthyesit e as vetes, pasi është e vërtetë që jam amator në këtë fushë, mirëpo jo aq, sa për të mos e kuptuar se shqipërimi fjalë për fjalë nuk të çon asgjëkundi e që gjërat nuk mund të shihen me këtë optikë. E megjithatë, jo për t'ia ulur vlerat shqipërimit të Shvarcit, të cilin shumëkush që nuk di gjermanishten mund ta krahasonte me përkthimet e panumërta në gjuhë të tjera, e as për të synuar ndonjë përsosmëri të pamundur, më duhet të shprehem se ky, përkthimi pra, është mjaft i tjetërsuar, është tjetër gjë, më ngjan shumë më tjetër nga ç'është origjinali, ose nga ajo që mendoj unë se na qenkësh ai.

Sa për të marrë një shembull: ndërsa unë skenën e Gëtes e përfytyroj pazgjidhshmërisht mesjetare, mitologjike e goxha të rëndë, me raportin e respektit të distancuar atë-bir mes tyre, që më vjen i tillë nga mënyra e komunikimit, kur i biri i drejtohet babait të tij me *mein Vater* - im atë, si të thuash, dhe ky atij me *mein Sohn* - biri im; në përkthimin e Shvarcit nuk e gjej këtë përpjestim, por në vend të tij has fjalët babush dhe bir, të cilat përçojnë një tjetër klimë, përgjërimtare ndoshta, mirëpo sidoqoftë të një tjetër natyre nga ajo e origjinalit. E gjitha kjo skizmë, ky dyzim mes dy teksteve, më përcjell përgjatë krahasimit të tyre me adashin e vet, ndërkohë që do të dëshiroja ta lexoja Gëten të shqipëruar shkëlqyer, siç do meritonte të përkthehej një gjigant i tillë, ndonëse e kam të qartë që kjo është veçse formë dëshirore shpesh e papërkthyeshme në realitet. Mbase, nga ana tjetër, pikërisht këto afrime të pakryera mirë, këto qasje të kithëta, në thelb të pamundura, ndaj origjinalit që nuk u jepet, na e bëjnë këtë të fundit edhe më të shtrenjtë, pak a shumë kjo e ngjashme me procesin që ndodh me atë që quhet "pasurimi" i mineraleve në botën e xeherorëve.

Do të dëshiroja gjithashtu, në vend të mbylljes, t'u sugjeroja atyre që nuk e lexojnë dot gjermanishten, por që ndoshta e kuptojnë kumtin muzikor të saj duke e dëgjuar, një urë tjetër të dy kulturave, Aleksandër Moisiun dhe recitimin e tij (të përsosur, sipas meje) të baladës në fjalë si edhe tingëllimën që i ka shtuar kësaj vepre Franc Shuberti.

Ngushëllime fort të epërme këto për këdo që nuk e ka mundësinë e të paturit të hartës territoriale të tekstit në shkallën një me një. Dhe, së fundmi, jo për të konkuruar me ndokënd, por thjesht për të qenë konstruktiv në kritikën time ndaj përkthimit të Shvarcit, po sjell një version përkthimi timin të vjershës në fjalë, version i papërfunduar e i cili nuk do e shohë dritën e botimit e për të cilin shpresoj të mos gjykohem nga lexuesi këtu.

nga J. V. Gëte

MBRETI I ZANAVE

Kush kalëron aq vonë natën nëpër erë?
Është i ati me fëmijën, me djalin e vet;
E mban kapur në krah me kujdes fort,
E mban mbërthyer pas vetes ngrohtë.

"Biri im, aq me frikë fytyrën ti pse e fsheh?" -
"Mbretin e zanave, o atë, ti a s'po e sheh?
Mbretin e zanave me kurorë dhe shtjellë?" -
"Biri im, është tisi, vazhda e një mjegulle.«

"Fëmijë i dashur ti, eja të shkosh me mua!
Lojëra shumë të bukura unë me ty do t'luaj;
Mjaft lule me ngjyra ka atij bregu, asaj ane,
Ime më ka mjaft rroba të arta dhe fustane."-

"Im atë, im atë, a nuk po e dëgjon vallë ti
Çka më premton nën zë i zanave mbreti?" -
"Rri urtë, qetësohu, rri i qetë, djali im;
Ndër gjethe të thara era po fëshfërin." -

"A do, djalë i mbarë, me mua të vish ti?
Vajzat e mia po të presin, janë bërë gati;
Vajzat e mia valles natore ia marrin sërish
E tunden e hidhen e këndojnë që të vish." -

"Im atë, im atë, dhe a nuk i sheh ti atje vallë
Në t'errët vajzat e mbretit të shtojzovalleve?" -
"Biri im, biri im, shoh qartë, shoh më së miri:
Ndrijnë ashtu gri luadhet e vjetra ngjyrë hiri." -

"Të dua, më magjeps nuri yt i bukur, i yti hir;
E nëse s'vjen vetë, duhet të të marr me pahir." -
"Im atë, im atë, tani më ngacmon, më ngau!
Mbreti i zanave mua më lëndoi e më vrau!" -

Të atin e zë tmerri; me revan nis kalëron,
Fëmijën ndër krahë po mban që rënkon,
Me mund tek heq keq arrin te shtëpia;
Nëpër krahë të tij vdekur kish fëmija.

J. W. Goethe

DER ERLKÖNIG

Wer reitet so spät durch Nacht und Wind?
Es ist der Vater mit seinem Kind;
Er hat den Knaben wohl in dem Arm,
Er faßt ihn sicher, er hält ihn warm.

"Mein Sohn, was birgst du so bang dein Gesicht?" –
"Siehst, Vater, du den Erlkönig nicht?
Den Erlenkönig mit Kron und Schweif?" –
"Mein Sohn, es ist ein Nebelstreif.«

"Du liebes Kind, komm, geh mit mir!
Gar schöne Spiele spiel' ich mit dir;
Manch' bunte Blumen sind an dem Strand,
Meine Mutter hat manch gülden Gewand." –

"Mein Vater, mein Vater, und hörest du nicht,
Was Erlenkönig mir leise verspricht?" –
"Sei ruhig, bleibe ruhig, mein Kind;
In dürren Blättern säuselt der Wind." –

"Willst, feiner Knabe, du mit mir gehn?
Meine Töchter sollen dich warten schön;
Meine Töchter führen den nächtlichen Reihn,
Und wiegen und tanzen und singen dich ein." –

"Mein Vater, mein Vater, und siehst du nicht dort
Erlkönigs Töchter am düstern Ort?" –
"Mein Sohn, mein Sohn, ich seh' es genau:
Es scheinen die alten Weiden so grau. –

"Ich liebe dich, mich reizt deine schöne Gestalt;
Und bist du nicht willig, so brauch' ich Gewalt." –
"Mein Vater, mein Vater, jetzt faßt er mich an!
Erlkönig hat mir ein Leids getan!" –

Dem Vater grauset's, er reitet geschwind,
Er hält in Armen das ächzende Kind,
Erreicht den Hof mit Müh' und Not;
In seinen Armen das Kind war tot.

përktheu: Arb Elo

Photo by Patrick Tomasso on Unsplash

ÇFARË DO TË NDODHË ME ROMANIN PAS KËSAJ?

Mbi gjininë e pashmangshme letrare pas-pandemike

nga Emily Temple

Kishin kaluar vetëm tre ditë në vetë-izolim kur im shoq u kthye nga unë dhe më tha: "A s'është dëshpëruese që tashmë e dimë se Ben Lerner-i do të shkruaj romanin më të mirë amerikan për këtë pandemi?" "Çështja është", - shkroi një romancier atë natë në FaceTime, "a do të ketë ndokush interesin edhe më të vogël lexojë për këtë pasi të ketë mbaruar? Tashmë jam ngopur me këtë temë".

Sloane Crosley botoi në "New York Times", një ese të shkurtër për pashmangshmërinë e një stuhie të ardhshme të romaneve të koronavirusit. Ajo na paralajmëron për rreziqet e të shkruarit për tragjedinë pa pritur të kalojë një kohë e mjaftueshme (dhe nuk ështe vetmja: "Nëse po shkruani prozë letrare për këtë pandemi, ju lutem mos e bëni", shkroi në Twitter Amber Sparks. "Jepini njëzet vjet kohë") por ajo mendon se ne të gjithë do të shkruajmë, gjithsesi.

Epo, ndoshta jemi duke e bërë, mbase nuk jemi, por le të shqyrtojmë disa gjëra. Pavarësisht nga çfarë thuhet vazhdimisht, shumë njerëz s'kanë shumë kohë të lirë. Veçanërisht ata me fëmijë, dhe veçanërisht gratë, kanë *më pak* kohë të lirë. ("Mbani shënime gjatë kësaj kohe! - porosisin shkrimtarët në Twitter. "Mbani ditar se si ndiheni çdo ditë! Do të jetë një dëshmi e këtyre kohërave!") E kush e merrte me mend se pandemia do të shoqërohej me detyra shtëpie.

Edhe ata që kanë shumë kohë të lirë për veten mund të mos ndihen krijues, sipas përvojës time, frika e vazhdueshme ekzistenciale s'është e volitshme për shkrimin krijues, veçanërisht nëse koha e lirë vjen për shkak të punës që të është mbyllur, dhe të ardhurat ulen. Artisti ideal i uritur që të gjithë e duam fort është mit shumë i dashur, dhe ka qenë gjithmonë. Kur duhet të punosh gjithë ditën për të përmbushur nevojat themelore, është e vështirë të shkruash romanin e madh amerikan gjatë orës që të ka mbetur para gjumit.

Tani për tani, le të fillojmë me një hamendësim të thjeshtë si ai i Crosley-t, sipas të cilit shkrimtarët, do të vazhdojnë të shkruajnë për këtë temë dhe pas kësaj. Nga ana tjetër, si do të jetë romani? Me siguri s'jemi duke shkruar *të gjithë* romane pandemike. Ose mbase jemi, edhe nëse s'mendojmë se po e bëjmë.

Ngjarjet e mëdha traumatike duhet dhe ndikojnë tek arti pasi ndodhin. Lufta e Parë Botërore ndihmoi në formësimin e traditës moderniste, dhe shumë klasik letrar që lexohen ende gjerësisht, u shkruan si përgjigje ndaj dhunës dhe trazirave shoqërore: "Zonja Dalloway", "Tokë e shkretë", "Lamtumirë armë", etj. Lufta e Dytë Botërore solli një bum letrar, veçanërisht për letërsinë amerikane, e cila po ndërkombëtarizohej rishtasi, dhe lexuesit e saj u njohën me vepra të përkthyera. Ende botohen çdo vit shumë libra ngjarjet e të cilëve ndodhin gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pas 11 shtatorit, patëm shumë romane të dobëta dhe disa të mirë. Shumica e tyre, të krijonë përshtypjen se janë jo me shumë vlerë. Ndoshta kur të kalojë më shumë kohë, kjo përshtypje do të ndryshojë.

(Sipas mendimit tim, arti më i mirë për 11 shtatorin mbetet memoriali në Ground Zero: fjalët e vetme që duhen shkruar janë emrat e atyre që vdiqën.) Kriza financiare ishte relativisht e qetë, u përdor nga letërsia me zgjuarsi, megjithëse "Hoteli prej xhami" i Emily St. John Mandel-it është roman shumë i mirë që merret pjesërisht me një skemë mashtruese financiare të stilit Bernie Madoff. Romanet dhe tregimet që lidhen me Trump-in janë disa, por shumica prej nesh s'janë të gatshëm t'u kushtojnë shumë vëmendje.

Nga këto ngjarje historike, krahasimi më i afërt me pandeminë e koronavirusit, të paktën në Shtetet e Bashkuara, dhe veçanërisht në Nju Jork, ku unë jam duke shkruar tani, është 11 shtatori. Ashtu si 11 shtatori, pandemia na goditi pa paralajmërim, ose për të qenë më të saktë, na goditi me një paralajmërim që qeveria jonë e shpërfilli. Dukej se gjithçka ndryshoi brenda një çasti. Ndiheshim të sigurt në realitetet tona relative, dhe të nesërmen zbuluam se ishim të pambrojtur në mënyrë të pashpresë. Ashtu si 11 shtatori, Covid-19 ka ndryshuar dhe do të ndryshojë mënyrën se si ne mendojmë për veten, për vendin dhe shoqërinë tonë.

Por sigurisht, 11 shtatori s'është model i saktë për pandeminë e koronavirusit, asgjë nuk është, të paktën asgjë nga ajo që kanë përjetuar njerëzit që janë gjallë sot. Tani për tani, ndryshe nga koha pas 11 shtatorit, pothuajse të gjithë po e ndiejmë këtë ndryshim çdo ditë, dhe kjo s'do të thotë se njerëzit në të gjithë vendin s'kanë mbajtur zi për 11 shtatorin, vetëm se për shumicën e njerëzve jashtë qytetit të Nju Jorkut, rutina e jetës së përditshme nuk ndryshoi. Dhe tani, s'ka asnjë armik të dukshëm kundër qeverisë sonë të ngathët, megjithëse mund të përpiqen ta bëjnë racistët. Ndoshta pandemia është thjesht më pak e kuptueshme, dhe më pak e lehtë ta përfshish në një kategori të caktuar si 11 shtatorin. Është po aq destabilizuese sa zgjedhja e Trump-it, por pa absurdin. Mund ta krahasoni me gripin spanjoll nëse doni, por është ende shumë e madhe për ta krahasuar me ndonjë gjë. Ndjenja mbizotëruese është ajo e pasigurisë. Planet e të gjithëve janë anuluar. Duket sikur e ardhmja është anuluar.

Kësisoj, them se po krijojmë njëfarë ideje se si do të ndihemi kur reshtim të mohuari faktet dhe efektet e ndryshimit të klimës. Kam menduar shumë, gjatë këtyre javëve të fundit për serinë e dokumentarëve të N.K. Jemisin-it "Toka e thyer", në të cilën toka ka vendosur pak a shumë ta refuzojë njerëzimin, dhe po bën çmos për t'a shkundur nga vetja, megjithëse njerëzimi vazhdon të kacaviret. Kjo është ndjesia që krijohet tani. Duket sikur natyra ka prekur fundin.

Po i përmend të gjitha këto vetëm **që** ta kemi parasysh si mund të shfaqen këto ndjenja të veçanta, ende të kudogjendura në romanet tona në vitet e ardhshme. Në fakt, librat Covid-19 po shfaqen. "Autorët po luftojnë për të botuar bestsellerin e parë Covid-19", është një titull. Fituesi i dukshëm i kësaj beteje është shkrimtari skocez Peter May, romani pandemik i të cilit "Izolimi total" (Lockdown) u refuzua nga botuesit në 2005 si "tepër jorealist", por ai arriti ta botojë këtë javë, për arsye mëse të dukshme. Pastaj kemi "PANDEMIA! Covid 19 trondit botën" të Slavoj Žižek-ut, ku në shënimin reklamues shkruhet: "Ndërsa një pandemi e paparë globale pushton planetin, kush më mirë se filozofi slloven plot ide, Slavoj Žižek mund të zbuloj kuptimet e tij më të thella, të mrekullohet nga paradokset e çuditshme dhe të hamendësoj thellësinë e pasojave, të gjitha në një mënyrë që të bën të djersish jo pak dhe të kërkosh të marrësh frymë thellë?"

Žižek po i dhuron të gjitha të ardhurat nga libri për shoqatën "Mjekët pa kufij", dhe natyrisht s'është një roman, por gjuha prapë ta jep atë ndjesi. Një mendim mbizotërues është se çdo gjë e shkruar për këtë kohë, ndërsa ende s'është tejkaluar, do të jetë pak a shumë e dobët. "Duke menduar për të gjithë letërsinë tejet të dobët që do të shkruhet për karantinën", shkroi në Twitter Moira Donegan. Phoebe Morgan, drejtor redaksie në shtëpinë botuese "HarperCollins" në Mbretërinë e Bashkuar, pajtohet me shoqen time romanciere, duke shkruar se "po këshillon autorët e saj të mos e shtojnë pandeminë në romanet

bashkëkohore. Arsyetimi: S'mendoj se dikush dëshiron ta kujtojë këtë përvojë ndërsa po përpiqet të arratiset në një botë të trilluar. Letërsia mbetet letërsi". Sidoqoftë, ata që po shkruajnë tani libra ku ngjarjet ndodhin në "të tashmen" duhet të vendosin nëse do të pranojnë dy katastrofa vdekjeprurëse globale: Trump-in dhe Covid-19.

Kultura letrare në gjuhën angleze s'është bllok guri, dhe ndërsa hapet (ngadalë, me dhimbje) për të përfshirë libra nga shkrimtarët e margjinalizuar dhe veprat e përkthyera, ajo po bëhet edhe më e shpërndarë, çka është një gjë e mirë. Por, në atë masë sa është e dobishme të flasim për romanin ose, e thënë më me elegancë, për prirjet e romaneve, hamendësimi im është që, pas një, ose dy apo tre vitesh, lexuesit dhe shkrimtarët do të vazhdojnë të rravgojnë të gjejnë atë që shumë prej nesh po rravgojnë ta gjejnë tani: arratisjen në botë të trilluar me fantazinë nga njëra anë, dhe katarsën nga ana tjetër. Katarsa mund të vijë në formën e parodisë, kritikës surrealiste, ose me në formën e krijimit me tis të hollë joletrar.

Ndoshta do të kemi disa romane për epidemitë e vitit 1918, ose mbase, s'e di, për difterinë. Ndoshta do të kemi studime të hollësishme personazhesh dhe romane të mëdha politike/shoqërore mbi kapitalizmin dhe korrupsionin dhe mënyrën se si po na vrasin. Mbase do kemi më pak drama të izoluara vetjake dhe marrëdhëniesh njerëzore pa jehona më të mëdha. Në fund të fundit, të paktën në këtë moment, lënda për këtë është tharë mjaft. Ndoshta do të kemi edhe të mediave që s'u morën drejtpërdrejt me të, edhe pandemia e koronavirusit ka të ngjarë të infektojë me gjendjen e saj shpirtërore edhe ato romane që do ta kenë periferik, "letërsia pas-pandemike", do të karakterizohet nga mosbesimi ndaj kapitalizmit, autoritetit, pranimit të korrupsionit, paqëndrueshmërisë dhe rrezikut si pikënisje fillestare e shformuar.

Në të vërtetë, parashikoj që romanet më të mira të pandemisë do të jenë romane që pak e përmendin pandeminë, por përkundrazi hulumtojnë të çuditshmen, shqetësimin, ankthin e mjedisit, frikën dhe pasigurinë që ka krijuar në jetët e kaq shumë prej nesh. Për shembull, kush do të shkruajë roman për një çift i cili gjatë muajit të mjaltit mbetet në Maldive, të vetmit mysafirë në një hotel ku dhomat kushtojnë duke filluar me 750 dollarë nata, dhe janë fare vetëm ata dhe *të gjithë pjesëtarët* e *stafit të hotelit*, të cilët s'mund të shkojnë në shtëpi për shkak të rregullave të karantinës dhe prandaj duhet të vazhdojnën t'u shërbejë këtyre dy personave darka me shandanë, dhe me mërzitjen/nihilizmin e tyre, "ua nxjerrin inatin duke ngacmuar pa pushim çiftin". Një roman si ky do të duhej të ishte rrëfim gjysmë surrealist për vetminë, kapitalizmin, monotoninë, burokracinë e tepërt, tërbimin, përkeqësimin mendor, dhe, me sa duket, marrjen frymë me maskë. Ndoshta mund të ndërkëmbehen rrëfimet sipas këndvështrimit të çiftit me rrëfimet e disa prej anëtarëve të stafit të hotelit. Ndoshta mund të ketë një rrëfim edhe nga

Photo by MILKOVÍ on Unsplash

një roman tjetër si "Personazhe të dëshpëruar" e Paula Fox-it, ose një tjetër "Ditët e braktisjes" të Elena Ferrantes.

Sipas terapistit tim, pandemia s'e ka ndryshuar natyrën e ndonjë prej klientëve të saj, gjithçka që po ndodhte më parë vijon të jetë aty, vetëm dendësohet. Kjo do të thotë se tani jemi të gjithë vetvetja, por *më shumë*. Jemi zhveshur nga modelet ngushëlluese të mjegullta të jetës së përditshme dhe jemi kthyer në versionet tona më të kulluara. Ndoshta e njëjta gjë do të ndodhë me romanin, trajektorja nuk do të ndryshojë, vetëm dendësia. Në fund të fundit, tashmë jemi në mes të një shpërthimit të një letërsie izolimi, e shkruar veçanërisht nga dhe për grate e reja dhe shpresoj se do të kemi edhe më shumë, sepse më shumë shkrimtarë do ta dinë se çfarë ndjesish ke kur nuk e sheh tjetrin për një kohë të pacaktuar. Kjo, meqë ra fjala, nuk është ankesë. Nga të gjitha mediumet që rrëfejnë, letërsia është më e mira për të rrëfyer çfarë ndodh brenda njeriut, kështu nëse romani i rikthehet kësaj force të pranuar zyrtarisht, aq më mirë.

Për të përdorur 11 shtatorin si modelin më të afërt: romanet më të mira ngjallin atmosferën e vendit në atë kohë, të qytetit në veçanti, në krahasim me vetë ngjarjen. "Viti im i pushimit dhe çlodhjes" i Ottessa Moshfegh-it s'ka të bëjë me 11 shtatorin, por për mënyrën se si ndiheshe të ishe gjallë asokohe. Dhe ashtu si 11 shtatori pati jehonë në të gjithë kulturën amerikane, duke ndryshuar dinamikën këndvështrimi i hotelit. Ky është romani koronavirusit që dua të lexoj.

Së fundi, përgjigja e vërtetë e pyetjes për fatin e romanit është e lidhur me fatin tonë: kjo do të thotë se gjithçka varet nga ajo që do të ndodh, dhe ne s'kemi asnjë ide se çfarë do të ndodhë. Nëse kjo pandemi zgjat disa muaj dhe pastaj përfundon, ose nëse shumë shpejt gjejmë një mënyrë për të mjekuar ata që janë të infektuar, ose nëse mundemi të prodhojmë një vaksinë, dhe (më e rëndësishmja) nëse jemi në gjendje të nxjerrim mësime dhe të mbrojmë vetveten sa më shumë të jetë e mundur nga pandemitë e ardhshme, shoqëria, dhe për këtë arsye, letërsia mund të gjejë qetësi pas stuhisë.

Shumë shkrimtarë thjesht do t'i shpërfillin këto pak muaj të vitit 2020 kur të gjithë ishim në grackën e shtëpive tona dhe mijëra njerëz vdiqën. Në fund të fundit, shkrimtarët ende mëdyshen të përfshijnë telefonat celularë në krijimet e tyre, sipas meje sepse letërsia klasike me të cilën janë rritur duke lexuar dhe nderuar, majat e letërsisë, nuk i kanë ato. As këtë s'e kanë. Nëse, nga ana tjetër, do të përballemi për vite të tëra me këtë sëmundje, me frikë dhe paqëndrueshmëri ekonomike, mendoj se të gjithë do të duhet të merremi me pandeminë në një mënyrë apo një tjetër. Ndoshta do ta bëjmë gjithsesi. Vetëm koha do ta tregojë.

Revista Letrare LitHub.
Përktheu: Granit Zela

Një ditë do të kujtojmë gjithçka dhe do të shkruajmë një roman

nga Sloane Crosley

Gjërat po lëvizin më shpejt nga sa mendohej, dhe jo vetëm në këndvështrimin e përhapjes së epidemisë. E djeshmja është sikur ka ndodhur rreth gjashtë vjet e gjysmë më parë. Ndërsa tentakulat e koronavirusit zgjaten çdo ditë, gjithçka mbetet të bëjnë shkrimtarët është thjesht të riprodhojnë realitetin. Por çfarë ndodh kur çdo shkrimtar në planet fillon të mbaj shënime për të njëjtën temë? A do t'i dorëzojmë të gjithë raportet tona në format librash në të njëjtën kohë, pas një viti?

Natyra e tragjedisë është e tillë që kërkon më shumë se sa jep, por ka krijuar edhe disa nga veprat letrare më të rëndësishme. Depresioni i madh solli "Vilet e zemërimit". Inkuizicioni spanjoll u bë shkas për të frymëzuar "Don Kishotin". Kolera i dha Albert Camus romanin "Murtaja" (le të themi kështu). Shekspiri, na kujtojnë, ka shkruar gjatë karantinës. Ka diçka ngushëlluese tek veprat e artit që merren me aspektet e shëmtuara të jetës kur të thonë se je bartës të vdekjes si tek "Vrasësi i rastësishëm dhe tregime të tjera" i Diana M. Grillo-s.

Nga pikëpamja artistike, është më mirë ta lësh tragjedinë të ftohet para se ta gëlltitësh dhe t'ua japësh surratit të gjithëve. Para së gjithash, "Don Kishoti" u botua afro një shekull pas inkuizicionit spanjoll. Artit duhet t'i jepet një shtrat metaforik po aq i gjerë sa largësia që po mbajmë nga njëri-tjetri. Tani për tani jemi të hutuar dhe të shqetësuar përtej normales, por gjërat do të zgjidhen (sa dhe kur mbetet për t'u parë), po pastaj? Më vjen ndërmend skena e fillimit në filmin e parë të Noah Baumbach-ut, "Shkelma dhe ulërima" (Kicking and Screaming), në të cilin dy shkrimtarë të rinj fillojnë të mbajnë shënime për një grindje ndërsa janë duke në zënkë e sipër.

"Po sikur të më duhet ky material për shkrimet e mia?" pyet djali.

"Po ta shohim një herë kush fiton", - ia kthen vajza.

Të gjithë e dimë se sa i kufizuar do të ngjante në të ardhmen një shkrim i hedhur në letër ndërsa ndodhin ngjarjet. Por kjo s'na ka ndaluar asnjëherë që të mos e bëjmë. S'po më ndalon të jem pjesë e një versioni të këtij episodi tani. Shihni rrëfimet menjëherë pas 11 shtatorit. Nuk janë jashtë kohe. Në të vërtetë, vetëm tani po ua nxjerrim fundin rrëfimeve për Luftën e Parë Botërore, por si të gjithë të tjerët, shkrimtarët ndiejnë nevojën e zbulimit të jetës si mënyrë për të mbijetuar.

Epoka jonë e veçantë me ngjan veçanërisht e ndjeshme ndaj kësaj shtyse. Pjesë e kësaj arsyeje është se përgjigjja jonë ndaj katastrofave (sulme terroriste, uragane, sulme me armë në shkolla) është dalja dhe shpallja e vdekjes së ironisë. Ashtu si personazhi i Steve Carell-it në komedinë "Zyra", i cili deklaron falimentimin duke bërtitur, "Shpall falimentimin!", s'mund të tregohesh thjesht i sinqertë ngaqë dëshiron t'i biesh shkurt perspektivës për gjendjen njerëzore apo sepse do që shakatë e tua të mos lëndojnë askënd. Kur koronavirusi të ketë kaluar, do të themi, sinqerisht, mbase për herë të parë në jetën tonë, se makthi ynë i gjatë kombëtar ka mbaruar. Por kjo s'do të jetë hera e fundit që do ta përdorim këtë frazë. Do të ketë një foto të dikujt në Instagram me flokët e prera pas karantinës, e sigurtë kjo. Megjithatë, për momentin, ndiejmë nevojën për të dëshmuar seriozitetin tonë në mediat sociale duke krijuar një gjendje shpirtërore unievrsale, dhe ky është helm për shkrimin e tanishëm të librit.

Çështja tjetër që ndan kohën tonë të veçantë nga vitet 1600 (përveç higjenës dhe ushqimeve) është zëri personal, me të cilin jemi mësuar, "unë" është fjala e shekullit. Si dikush që në mënyrë të përsëritur që ka zgjedhur të shkruajë për jetën e saj, mua më duket brengosëse perspektiva e të qenit e detyruar të jem pjesë e një një fatkeqësie globale. Kjo nuk është më histori e disa njerëzve (një romancë që ndodh në një anije e cila është në karantinë, natyrisht!). Kjo është tani historia e të gjithëve. Dhe ja ku kemi një brez shkrimtarësh, bashkë me mua, të prirur tashmë drejt rrëfimit joletrar, të cilët janë gati të kalojnë një kohë të pambarim me sytë e ngulitur në mure. Ja, pra. Urra!

The New York Times

"Kjo është mrekullia e dashurisë."
-Romain Rolland, Nobel 1915

LEV TOLSTOI

lumturia martesore

OnufriRoman